



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio

A. nr. 293/2023

lidhur me ndikimin e korrupsionit në të drejtat e njeriut në Kosovë

Drejtuar:

Z. Albin Kurti, kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Z. Rustem Thaqi, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Z. Yll Buleshkaj, drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Kopje:

Z. Arian Gashi, kryesues, Këshilli Prokurorial i Kosovës

Z. Habit Hajredini, drejtor, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Arben Vitia, ministër në detyrë, Ministria e Shëndetësisë

Prishtinë, më 10 shtator 2026

Ky dokument është përgatitur nga Institucioni i Avokatit të Popullit, me ndihmën e Institutit për Hulumtime Zhvillimore “Riinvest”, me mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Opinionet e shprehura në këtë dokument janë të autorit(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-it ose të Qeverisë Gjermane.

Qëllimi i Raportit

1. Në përputhje me mandatin e tij kushtetues dhe ligjor, Avokati i Popullit shqyrton veprimet ose mosveprimet e autoriteteve publike për atë që ato mund të rezultojnë në shkelje të të drejtave të njeriut. Këto veprime apo mosveprime të autoriteteve publike mund të ndodhin për shkak se mund të jenë të nxitura nga korrupsioni. Korrupsioni në këtë aspekt ndikon në vendimmarrje të pabazuar dhe jo-objektive, devijon burimet publike dhe mundëson arbitraritet në funksionimin e autoriteteve publike, duke cenuar besimin në institucione dhe duke dobësuar efektivitetin e garancive ligjore dhe administrative.
2. Megjithatë vendi ka miratuar një kornizë të gjerë ligjore dhe ka funksionalizuar një sërë mekanizmesh për parandalimin dhe luftimin e tij, korrupsioni mbetet i pranishëm në shumë sektorë dhe shpesh i normalizuar në praktika të përditshme. Politikat kundër korrupsion shpesh trajtohen në këndvështrimin penal dhe administrativ, duke lënë në hije ndikimin e tij në të drejtat e njeriut. Si i tillë, korrupsioni vazhdon të jetë një nga sfidat strukturore në Kosovë, me ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në funksionimin e institucioneve, mirëqenien e qytetarëve dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut.
3. Ky raport shqyrton ndikimin e korrupsionit në gëzimin e të drejtave të njeriut, duke u bazuar në gjetje empirike, përfshirë edhe një anketim me qytetarë. Fokusi i raportit është analizimi i korrupsionit ekskluzivisht përmes prizmit të të drejtave të njeriut, duke vlerësuar mënyrën se si praktikët korruptive dhe dështimet institucionale pengojnë gëzimin efektiv të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Po ashtu, për të diskutuar lidhur me të gjeturat e anketave, Avokati i Popullit ka mbajtur një tryezë me përfaqësues të institucioneve si dhe me organizata të shoqërisë civile.
4. Analiza e paraqitur në këtë raport e trajton, për rrjedhojë, korrupsionin jo si fenomen të izoluar, por si dështim sistematik të qeverisjes me pasoja të drejtpërdrejta dhe të matshme në të drejtat e njeriut, siç dëshmohet edhe nga përvojat e raportuara nga qytetarët përmes pyetësorit dhe burimeve të tjera të të dhënave.
5. Duke parë prezencën e korrupsionit dhe ndikimin e tij në të drejtat e qytetarëve, ky raport përfundon me rekomandime që synojnë parandalimin dhe uljen e korrupsionit, në mënyrë që çdo qytetar t'i gëzojë të drejtat në mënyrë të barabartë. Për ta adresuar këtë fenomen, nevojitet bashkëpunim institucional dhe ngritje kapacitesh, si dhe inkurajim të qytetarëve për t'i paraqitur rastet ku përmes korrupsionit shkelen të drejtat e tyre.

Baza ligjore dhe kompetencat e Avokatit të Popullit

6. Në përputhje me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta): “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.” Kushtetuta më tutje në nenin 135, paragrafi 3, parasheh: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”
7. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);*
 - *të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 4);*
 - *Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave (neni 16, paragrafi 8);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënparagrafi. 1.2);*
 - *t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (neni 18, par. 1, nënparagrafi. 6).
8. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon t’i përmbushë këto përgjegjësi sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore të lartcekura.

Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut

9. Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe e lirive themelore është bazamenti mbi të cilin ndërtohet sistemi kushtetues i Kosovës. Mbrojtja e të drejtave të njeriut, që përmendet në preambulë dhe në pjesët e tjera, përkufizohet si vlerë kushtetuese për shoqërinë. Ky dokument ofron një numër të madh të të drejtave të garantuara dhe njëkohësisht siguron instrumente ndërkombëtare dhe mekanizma mbrojtës¹. Kështu, jeta institucionale përshkohet qenësisht nga mbroja e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore.
10. Të drejtat e njeriut paraqesin dimensionin e kufizimit të shtetit në raport me qytetarin. Nocioni klasik është se vetëm veprimet apo mos veprimet e shtetit paraqesin shkelje të të drejtave të njeriut. Megjithatë, përtej kësaj, në një analizë më të thellë, rezulton se korrupsioni është një burim i konsiderueshëm i shkeljes së të drejtave të njeriut. Përkundër kësaj, luftimi i korrupsionit nuk njihet si e drejtë dhe përgjegjësi specifike, ndonëse ndikimi i tij negativ është i theksuar në shumë aspekte të jetës së qytetarëve, duke prekur direkt të drejtat e tyre fundamentale.
11. Kjo qasje është e mbështetur edhe në dokumentet e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Zyra e Komisionarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut thekson se korrupsioni ka efekt shkatërrues mbi institucionet shtetërore dhe mbi kapacitetin e shteteve për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e njeriut, veçanërisht për

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Preambula, neni 7, kapitujt 2, 3 etj.

personat dhe grupet në situatë të cenueshmërisë dhe marginalizimit.² Po ashtu, korrupsioni dhe rrjedhat e paligjshme financiare devijojnë të hyrat publike dhe dobësojnë buxhetet, që do të duhej të shërbenin për shëndetësi, banim, arsim dhe shërbime të tjera esenciale.³ Në këtë kuptim, korrupsioni nuk duhet parë vetëm si shkelje e integritetit administrativ apo penal, por edhe si pengesë strukturore për realizimin efektiv të të drejtave të njeriut.

12. Avokati i Popullit thekson se, edhe miradministrimi është i rëndësishëm për të minimizuar shkeljet potenciale të të drejtave të njeriut. Në raportin e tij për Parimet e Miradministrimit⁴ ka theksuar: “*Procesi që mundëson shfrytëzim të resurseve ekzistuese me qëllim të realizimit të të drejtave të qytetarit, **duke iu shmangur korrupsionit**, nuk mund të mos shërbejë si bazë për krijimin e një definicioni të unifikuar mbi “qeverisjen e mirë”. Koncepti i qeverisjes së mirë është qartësuar në rezolutën 2000/64, sipas të cilës qeverisja e mirë bazohet në këto attribute:*

- *transparenca*
- *llogaridhënia*
- *përgjegjësia*
- *pjesëmarrja*
- *përgjegjshmëria (ndaj nevojave të qytetarëve)*

Qeverisja e mirë, miradministrimi dhe të drejtat e njeriut ndërlidhen në atë mënyrë që fuqizojnë njëra tjetrën. Në një dokument të Komisionit Evropian për Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venedikut), shtjellohet dallimi ndërmjet “Qeverisjes së mirë” dhe miradministrimit, sepse shpesh mendohet se qeverisja e mirë e përfshinë miradministrimin. Parimi i miradministrimit bazohet në të drejtat procedurale që janë qartazi të identifikueshme, shkelja e supozuar e të cilave mund të paraqitet në gjykatë. Së këndejmi, miradministrimi pranohet gjerësisht si koncept ligjor në vete, i cili përfshihet në dokumentet ndërkombëtare si dhe në rendin ligjor në një numër shtetesh. Ky dallim për nga natyra duhet të kihet parasysh në mënyrë që qeverisja e mirë të mos barazohet me miradministrimin.”

13. Abuzimi i autoritetit është me të vërtetë një formë e keqadministrimit, përkatësisht shkeljet e kryera nga zyrtarët publikë në fushën e së drejtës administrative. Megjithatë, kjo mund të përfshihet në fushën e së drejtës penale për shkak të faktorëve të caktuar⁵. Megjithatë, miradministrimi në vetvete nuk është objekt i shqyrtimit në këtë raport, por ndërlidhja e abuzimit të pozitës në çfarëdo forme është e rëndësishme të kuptohet si veprim që mund t’i prekë të drejtat e njeriut.

² Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *Corruption and Human Rights*, ku theksohet se korrupsioni ka efekt shkatërrues mbi institucionet shtetërore dhe kapacitetin e shteteve për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e njeriut. Shih: <https://www.ohchr.org/en/good-governance/corruption-and-human-rights>

³ Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights, *Corruption and Human Rights: A Practical Guide*, 2025, fq. 6.

⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit, Parimet e Miradministrimit, i publikuar më 7 nëntor 2018 (shih: file:///C:/Users/acavdarbasha/Downloads/SHQIP_Parimet-PER-MIRADMINISTRIMIN-permbledhje-nga-Avokati-i-Popullit-2.pdf)

⁵ Guslan, O.F. (2018). “Maladministration in Corruption Case: A Study of Limitation on the Criminal Action” *Indonesian Journal of Criminal Law Studies* 3(2): 147-156. DOI: 10.15294/ijcls.v3i2.13249

14. Korrupsioni mundëson si shkeljet e të drejtave të njeriut, ashtu edhe dobësimin e demokracisë. Nga ana tjetër, kjo ndikon në rritjen e korrupsionit, duke krijuar një rreth vicioz⁶.
15. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsion (UNCAC) paraqet dokumentin më të rëndësishëm global kundër korrupsionit. Kjo Konventë thekson qartazi se korrupsioni, krahas të tjerave, çon në shkelje të të drejtave të njeriut⁷.
16. Në anën tjetër, Këshilli i të Drejtave të Njeriut i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara ka miratuar Rezolutën mbi ndikimet negative të korrupsionit në të drejtat e njeriut. Kjo rezolutë thekson se promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, parandalimi dhe luftimi i korrupsionit përforcojnë njëra-tjetrën. Sipas kësaj rezolute, grupet e marginalizuara janë më të ekspozuara ndaj ndikimit të korrupsionit në realizimin e të drejtave të tyre⁸.
17. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krim e njeh lidhjen ndërmjet të drejtave të njeriut dhe përpjekjeve për luftim të korrupsionit. Kjo zyrë thekson se është e përkushtuar të mbështesë shtetet në zbatimin e UNCAC-së dhe për ta adresuar korrupsionin në një gamë të gjerë sektorësh, përmes perspektivës së të drejtave të njeriut, duke përfshirë sektorin e arsimit, sportit, shëndetësisë, mjedisit, integritetit gjyqësor etj.⁹
18. Në rastin e vlerësimit të shkeljeve të drejtave të njeriut, autoritetet duhet të kenë kujdes të mos e bëjnë shkeljen e tyre duke respektuar, mbrojtur dhe përmbushur ato. Detyrimi për të respektuar nënkupton që shteti të mos ndërhyjë në ushtrimin e të drejtave, derisa detyrimi për t'i përmbushur kërkon veprim aktiv të shtetit për përmbushjen e të drejtave të njeriut, ashtu që shteti duhet të ndërmarrë masa aktive për realizimin e tyre. Detyrimi për të mbrojtur t'i drejtat e njeriut është kyç për lidhjen korrupsion – të drejta të njeriut: shteti duhet të parandalojë, hetojë dhe ndëshkojë për shkeljet e kryera. Korrupsioni mund ta bëjë këtë të pamundur, duke penguar hetimet, duke krijuar mosndëshkueshmëri ose duke toleruar struktura abuzive¹⁰.
19. Qasja konceptuale e të drejtave të njeriut dallon nga qasja konceptuale antikorrupsion¹¹. Korrupsioni shihet vetëm në prizmin ekonomik dhe politik në formën e përvetësimit të pasurisë. Megjithatë duhet shikuar korrupsionin edhe për nga ndikimi që ka në të drejtat e njeriut, veçmas në ndikimin negativ në barazinë e qytetarëve dhe bizneseve, dhe kufizimin e pjesëmarrjes në shoqëri për subjekte të caktuara¹². Trajtimi i korrupsionit nga ky kënd kontribuon në ngritjen e vetëdijes kolektive, rritjen e intolerancës shoqërore ndaj këtij fenomeni, si dhe mbrojtjen e qytetarëve nga ndikimet negative.

⁶ “CPI 2021: Corruption, human rights and democracy”. Transparency International. 25 janar 2022. (Shih linkun: <https://www.transparency.org/en/news/cpi-2021-corruption-human-rights-democracy>).

⁷ “UNITED NATIONS CONVENTION AGAINST CORRUPTION”. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krim. Nju Jork, 2004. (Shih linkun: https://www.unodc.org/documents/brussels/UN_Convention_Against_Corruption.pdf)

⁸ General Assembly. Human Rights Council, The negative impact of corruption on the enjoyment of human rights, 6 July 2023, f.1-2.

⁹ “Human rights”. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krim. (Shih linkun: <https://www.unodc.org/corruption/en/learn/about-corruption/human-rights.html>)

¹⁰ Po aty, faqe 21-22.

¹¹ Human Rights Council Advisory Committee, *Final report on the issue of the negative impact of corruption on the enjoyment of human rights*, A/HRC/28/73, 5 January 2015.

¹² “Corruption and Human Rights”. Qendra për të drejtat civile dhe politike. Faqe 9 dhe 10. Shtator 2019 (shih linkun: https://www.geneva-academy.ch/joomlatools-files/docman-files/Corruption_and_HR.pdf).

20. Korrupsioni përbën një nga pengesat kryesore për mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Korrupsioni ofron qasje diskriminuese të qytetarëve në shërbimet publike, duke u vënë në favor të atyre që përmes formave korruptive janë në gjendje të ndikojnë tek autoritetet publike¹³. Sipas Këshillit për të Drejtat e Njeriut, është e vështirë që të gjendet një e drejtë e njeriut, e cila nuk mund të cenohet nga korrupsioni¹⁴. Në vijim po listojmë disa prej tyre.
21. ***E drejta për jetë, liri dhe siguri*** të personit pengohet drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga korrupsioni¹⁵. Mosveprimi i institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, mungesa e hetimit dhe tolerimi i dhunës institucionale përmes korrupsionit rrezikojnë të drejtën për jetë, liri dhe siguri.
22. Korrupsioni mund të bëhet pengesë serioze për ***gëzimin e së drejtës së pronës***. Një zyrtar publik që ia mohon dikujt të drejtat pronësore, në çfarëdo forme, përmes ryshfetit shkel drejtpërdrejt të drejtën e tij për pronë¹⁶.
23. Korrupsioni cenon edhe ***të drejtat zgjedhore***. Për shembull, blerja e votave është shkelje e së drejtës së votës, sepse kufizon zgjedhjen e lirë të qytetarëve dhe ndikon në procesin zgjedhor duke minuar legjitimitetin e tij. Një shembull tjetër, që lidhet me të drejtën për t'u zgjedhur, është kur ndonjë kandidat pengohet në mënyrë arbitrare që të kandidojë për shkak të një ryshfeti që ka marrë¹⁷.
24. Për shkak të natyrës së saj dhe mënyrës së inicimit të rasteve, deri më tani, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk ka trajtuar ndonjë rast kur shkelja e së drejtës së njeriut është ndërlidhur me korrupsionin. Megjithatë, në kuptim të standardeve që ajo ka vendosur në jurisprudencën e saj, është e qartë se ato standarde nuk mund të jenë funksionale në rast të ekzistimit të korrupsionit, qoftë edhe në raport me perceptimin e tij. Si shembull, një ndër të drejtat e parapara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e drejta për një proces të rregullt, që thekson: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme...” Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), për të përcaktuar nëse një organ është i pavarur, aplikohen disa kriteret, ndër të cilat edhe ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe nëse organi duket apo paraqitet si i pavarur¹⁸. Në këtë kuptim, korrupsioni cenon drejtpërdrejt kriteret që vlerësojnë pavarësinë e një gjykate, e që ndikon po ashtu

¹³ “Knowledge tools for academics and professionals - Module 7 Corruption and Human Rights”. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krim. Faqe 11. (Shih linkun:

[https://grace.unodc.org/grace/uploads/documents/academics/Anti-Corruption Module 7 Corruption and Human Rights.pdf](https://grace.unodc.org/grace/uploads/documents/academics/Anti-Corruption%20Module%207%20Corruption%20and%20Human%20Rights.pdf)).

¹⁴ Po aty, fq. 9.

¹⁵ “Corruption and Human Rights”. Qendra për të Drejtat Civile dhe Politike. Fq. 13. Shtator 2019 (shih linkun: [https://www.geneva-academy.ch/joomlatools-files/docman-files/Corruption and HR.pdf](https://www.geneva-academy.ch/joomlatools-files/docman-files/Corruption%20and%20HR.pdf)).

¹⁶ “Human Rights and Countering Corruption”. Geneva Academy. Faqe 9. (Shih linkun: <https://www.geneva-academy.ch/joomlatools-files/docman-files/Human%20Rights%20and%20Countering%20Corruption.pdf>).

¹⁷ “Knowledge tools for academics and professionals - Module 7 Corruption and Human Rights”. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krim. Fq. 16. (Shih linkun: [https://grace.unodc.org/grace/uploads/documents/academics/Anti-Corruption Module 7 Corruption and Human Rights.pdf](https://grace.unodc.org/grace/uploads/documents/academics/Anti-Corruption%20Module%207%20Corruption%20and%20Human%20Rights.pdf)).

¹⁸ Aktgjykim “CASE OF FINDLAY v. THE UNITED KINGDOM (Application no. 22107/93)”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Strasburg, 25 shkurt 1997. Paragrafi 73. (Shih linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":"001-58016"}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)).

drejtpërdrejt në cenimin e një prej të drejtave fundamentale të njeriut, që është e drejta për gjykim të drejtë, si një e drejtë procedurale që mbrohet të gjitha të drejtat e tjera të njeriut.

25. Për këtë arsye, siç u tha, është tejet e vështirë të gjendet ndonjë e drejtë e njeriut që nuk mund të cenohet nga korrupsioni, qoftë drejtpërdrejt apo indirekt.
26. Për sa i përket kornizës legislative në Kosovë, të drejtat e njeriut mbrohen, ndër të tjera, edhe me norma penale. Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës përmban një kapitull të veçantë për veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut¹⁹. Në po këtë kapitull bëhet edhe një ndërlidhje e korrupsionit me të drejtat e njeriut, ku kryerja e këtyre veprave penale përmes keqpërdorimit të detyrës zyrtare paraqet formë të kualifikuara të veprës penale²⁰. Në rastet e tjera, ky Kod nuk bën ndonjë ndërlidhje me të drejtat e njeriut, duke ndërtuar ndonjë formë të kualifikuar të veprës penale nëse dëmi shkaktohet në të drejtat e njeriut. Megjithatë, kur në kuadër të figurës së veprave penale të korrupsionit përmendet “*dëmi*”, normalisht se ky dëm përfshin edhe cenimin e të drejtave të njeriut, në çfarëdo forme.

Kuadri ligjor dhe institucional për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit

Parandalimi i korrupsionit

27. Parandalimi luan një rol thelbësor në luftimin e korrupsionit. Ai ndihmon në adresimin e korrupsionit para se të shkaktojë pasoja serioze negative dhe kontribuon në trajtimin e shkaqeve të tij rrënjësore. Strategjitë dhe masat efektive parandaluese forcojnë integritetin e institucioneve publike dhe të zyrtarëve publikë, duke promovuar kështu besimin dhe sigurinë e publikut në veprimet e tyre²¹.
28. Institucioni kryesor në fushën e parandalimit të korrupsionit është Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), e cila tanimë funksionon në bazë të Ligjit [të ri] Nr. 08/L-017 për APK-së, i cili hyri në fuqi në gusht të vitit 2022. Në këtë Ligj janë të përfshira një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me parandalimin e korrupsionit. Në fushën e parandalimit të korrupsionit, relevancë të madhe kanë edhe tri ligje të tjera: Ligji nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Ligji nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik dhe Ligji nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Kurse përgjegjëse për mbikëqyrjen e implementimit të të tri këtyre ligjeve është APK-ja.
29. Një prej mjeteve për parandalimin e korrupsionit është menaxhimi i konfliktit të interesit. Sipas Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik: “*Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.*”²² Ky ligj përcakton veprimet e ndaluara për të gjithë zyrtarët publikë, papajtueshmërinë e zyrtarëve publikë, mekanizmat për identifikimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit etj. Kjo për arsye që vendimmarrja publike të jetë e fokusuar në interesin publik dhe të mos ndikohet nga interesi privat.

¹⁹ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Kapitulli XVII.

²⁰ Po aty, neni 414.1.

²¹ “*Preventive measures (chapter II)*”. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krime (Shih linkun: <https://www.unodc.org/corruption/en/learn/ehat-is-uncac/prevention.html>)

²² Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Neni 6.

30. Deklarimi i pasurisë është një mjet tjetër për parandalimin e korrupsionit. Ligji Nr. 08/L-108 ka për qëllim përcaktimin e sistemit të deklarimit të pasurisë, duke përfshirë mënyrat dhe procedurat e deklarimit të pasurisë dhe të dhuratave, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së deklaruar dhe të dhuratave, si dhe subjektet deklaruese me qëllim të parandalimit të korrupsionit, konfliktit të interesit dhe fuqizimin e integritetit të institucioneve publike, përfshirë edhe sanksionimin. Sipas këtij Ligji, janë gjithsej 49 kategori të zyrtarëve publikë të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë²³. Qëllimi i deklarimit të pasurisë është ngritja e integritetit dhe transparencës së zyrtarëve publikë dhe të shërbejë si mjet për parandalimin e korrupsionit.
31. Planet e integritetit janë një mjet tjetër i rëndësishëm për parandalimin e korrupsionit. Planet e integritetit paraqesin dokumente që përgatiten si rezultat i vetëvlerësimit të institucionit të ekspozimit të rrezikut të pranisë dhe zhvillimit të korrupsionit dhe ekspozimit ndaj veprimeve të papranueshme etike dhe profesionale²⁴. Planet e integritetit duhet të miratohen nga organet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale të Kosovës. Këto plane përmbajnë vetëvlerësimin e ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, informacione mbi fushëveprimin e punës së institucionit dhe burimeve njerëzore të angazhuara në institucion, llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të cenimit të integritetit etj.²⁵ Draftimi, monitorimi dhe zbatimi adekuat i këtyre planeve mundëson që institucionet, përmes një vlerësimi të qartë për vetën e tyre, t'i analizojnë dhe parandalojnë format e ndryshme korruptive brenda një sektori apo institucioni të caktuar. Kështu, planet e integritetit nuk duhet të shihen si një obligim formal, por si një mjet i rëndësishëm për parandalimin e korrupsionit.
32. APK-ja ka edhe kompetenca të tjera të rëndësishme në fushën e parandalimit të korrupsionit. Këtu bën pjesë vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në fusha apo sektorë të ndryshëm. Sipas Ligjit për APK-në, Agjencia mund të kryejë vlerësime të rrezikut në fushat apo sektorët që konsiderohen të jenë veçanërisht të ekspozuar ndaj rreziqeve të korrupsionit dhe në fusha apo sektorë, të sugjeruar nga organizatat publike, ku sugjerimet e tyre nuk janë të detyrueshme për Agjencinë²⁶. Autorizim tjetër i APK-së në fushën e parandalimit të korrupsionit është po ashtu vlerësimi i akteve ligjore kundër korrupsionit²⁷.
33. Me qëllim të pasqyrimin të vullnetit institucional, por edhe sinkronizimit të përpjekjeve institucionale kundër korrupsionit, Strategjia kundër Korrupsionit ka një rol të rëndësishëm. Sipas Ligjit për APK-së, *“Strategjia shtetërore dhe plani i veprimit kundër korrupsionit hartohet dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës”*. Avokati i Popullit vëren se kjo Strategji, deri më tani nuk është miratuar. Kështu, tash e shumë vite, Kosovës i mungon një Strategji Shtetërore kundër Korrupsionit.

²³ Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave. Nenet 3, 4 dhe 5.

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60591> 3.1.1.6

²⁵ Po aty, neni 25.

²⁶ Ligji Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Neni 26.

²⁷ Po aty, neni 27.

Luftimi i korrupsionit

34. Luftimi i korrupsionit, si koncept, zbatohet në rastet kur parandalimi i tij nuk ka qenë i mundur. Përkatesisht, ky koncept zbatohet pasi të jetë kryer një vepër penale dhe kryerësi të vihet para drejtësisë, duke marrë dënimin e merituar për veprën e kryer.
35. Veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare janë të përcaktuara me Kodin Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës. Në kapitullin XXXIII të këtij Kodi janë përcaktuar 17 vepra penale të korrupsionit.
36. Në këtë Kapitull, Kodi Penal e trajton korrupsionin jo vetëm përmes formave klasike të ryshfetit, por edhe përmes një game më të gjerë të sjelljeve që cenojnë integritetin e ushtrimit të detyrës zyrtare. Këtu përfshihen keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik, keqpërdorimi i informatës zyrtare, konflikti i interesit, përvetësimi në detyrë, mashtrimi në detyrë, përdorimi i paautorizuar i pasurisë, marrja dhe dhënia e ryshfetit, ushtrimi i ndikimit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, zbulimi i fshehtësisë zyrtare, falsifikimi i dokumentit zyrtar, arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme, përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë gjatë bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor, si dhe mosraportimi apo raportimi i remë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobive të tjera materiale ose detyrimeve financiare. Kjo tregon se legjislacioni penal nuk e kufizon korrupsionin vetëm në shkëmbimin e drejtpërdrejtë të parave apo dhuratave, por e trajton atë edhe si keqpërdorim të autoritetit publik, informacionit zyrtar, pasurisë publike, procedurave të prokurimit, vendimmarrjes gjyqësore dhe detyrimeve të transparencës.
37. Në kontekstin e këtij raporti, rëndësi të veçantë ka fakti se disa prej këtyre veprave lidhen drejtpërdrejt me cenimin e të drejtave të njeriut. Për shembull, te vepra penale e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, Kodi Penal e përfshin shprehimisht si element të veprës edhe veprimin e personit zyrtar me qëllim që *“t’i shkel të drejtat e personit tjetër”*. Po ashtu, në kuadër të këtij neni, si forma të shpërdorimit të detyrës zyrtare përfshihen edhe nënshtrimi i personit tjetër në keqtrajtim, arrest, ndalim, kontroll, marrje apo barrë të kundërligjshme, si dhe ndalimi ose pengimi i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor. Në këtë kuptim, Kodi Penal krijon një lidhje të qartë ndërmjet korrupsionit zyrtar dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut: kur autoriteti publik përdoret për përfitim të kundërligjshëm, për favorizim, për dëmtim të tjetrit ose për pengim të ushtrimit të një të drejte, korrupsioni nuk mbetet vetëm çështje e integritetit institucional, por shndërrohet në mekanizëm për cenimin konkret të barazisë, qasjes në shërbime, sigurisë juridike dhe mbrojtjes efektive të qytetarëve.
38. Me një përjashtim, veprat penale të korrupsionit kryhen vetëm me dashje direkte dhe nuk mund të kryhen nga pakujdesia²⁸. Kjo nënkupton se për t’u konsideruar se është kryer një vepër penale e natyrës korruptive, është e domosdoshme që të ketë qëllim kriminal, që konsiston në qëllimin për krijimin e favoreve vetes apo tjetrit, apo t’i shkaktohet dëm dikujt. Kështu, qëllimi kriminal, krahas elementeve të tjera, është element thelbësor i veprave penale të korrupsionit. Për këtë arsye, jo çdo shkelje hyn në domenin e korrupsionit zyrtar, përderisa nuk vërtetohet elementi i qëllimit kriminal.

²⁸ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Neni 426, paragrafi 3.

39. Për sa i përket klasifikimit të korrupsionit, në kuadër të përcaktimit të veprave penale, secila prej tyre e ka formën e saj bazë dhe formën e saj të kualifikuar. Si shembull, dhënia e ryshfetit, si vepër bazë, dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet. Por, nëse vlera e ryshfetit tejkalon shumë 15.000 euro, atëherë kemi të bëjmë me formën e kualifikuar të veprës penale, e cila dënohet deri në tetë (8) vjet burgim²⁹.
40. Përtej kësaj, legjislacioni tanimë ka definuar edhe kuptimin e korrupsionit të lartë. Sipas Ligjit për Prokurorinë Speciale, janë listuar 15 kategori të zyrtarëve publikë, kryerja e korrupsionit nga të cilët konsiderohet korrupsion i profilit të lartë³⁰.
41. Rastet e korrupsionit hetohen nga Prokurori i Shtetit, përkatësisht Departamentet për Krime të Rënda të Prokurorive Themelore³¹. Përjashtim këtu bën korrupsioni i profilit të lartë, i cili hetohet nga Prokuroria Speciale³². Për sa i përket gjykimit, këto raste gjykohen nga Departamentet për Krime të Rënda në Gjykatat Themelore, me përjashtim të rasteve të ngritura nga Prokuroria Speciale, të cilat gjykohen nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë³³.
42. Në hetimin e rasteve të korrupsionit, Prokurori i Shtetit ka bashkëpunim me institucionet e tjera. Bashkëpunimi më i madh në këtë rast është me Policinë e Kosovës, e cila deponon numrin më të madh të kallëzimeve penale në Prokurori. Veprimet e Policisë kryhen mbi bazën e urdhrave të Prokurorit të Shtetit.
43. Me rastin e pranimit të një rasti korruptiv, Prokurori i Shtetit mund të hedhë kallëzimin penal apo mund të fillojë hetimet. Pas zhvillimit të hetimeve, ai mund të pushojë hetimet apo mund edhe të ngrejë aktakuzë. Sipas Kodit të ri të Procedurës Penale [nenet 84 dhe 156.8], ndaj vendimit për hedhje të kallëzimit penal dhe vendimit për pushimin e hetimeve, pala e dëmtuar ka të drejtën e ankesës në Prokurorinë e Apelit. Kjo zgjidhje ligjore ngre dilema lidhur me të drejtat e viktimave, që nuk kanë mundësi t'i atakojnë në gjykatë vendimet e Prokurorit të Shtetit për hedhjen e kallëzimeve penale apo pushimit të hetimeve. Për më tepër, ata nuk kanë mundësi të iniciojnë padi penale private, andaj gjithçka mbetet nën vlerësimin e një institucioni të vetëm, Prokurorit të Shtetit. Këto aktvendime të Prokurorit të Shtetit janë aktvendimet e vetme në rendin juridik kosovar që nuk kanë mundësi atakimi në gjykatë. Duke qenë se vendimet për hedhjen e kallëzimeve penale dhe pushimin e hetimeve nuk i nënshtrohen kontrollit të drejtpërdrejtë gjyqësor, Prokuroria duhet të garantojë standard të lartë të arsyetimit, transparencës dhe llogaridhënies në këto vendimmarrje, veçanërisht në rastet që prekin interesin publik dhe të drejtat themelore të njeriut.
44. Me qëllim të ngritjes së efektivitetit në identifikimin e rasteve të korrupsionit, është e rëndësishme që institucionet e sistemit të drejtësisë t'i bindin qytetarët në efektivitetin e rasteve që ata ngrenë. Nisur nga fakti se Prokurori i Shtetit vepron në secilin rast kur ka dyshime se është kryer një vepër penale, pa marrë parasysh mënyrën se si është informuar, është tërësisht e qartë se rastet penale mund të fillojnë edhe në bazë të raportimeve anonime. Pos se, përtej kësaj, është shumë e rëndësishme që Prokurori i

²⁹ Po aty, neni 422.

³⁰ Ligji Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale, neni 3.1.1.4.

³¹ Ligji Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, neni 13.4.4.

³² Ligji Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale, neni 9.1.1.14.

³³ Ligji Nr. 06/L - 054 për Gjykatat, nenet 18 dhe 19.

Shtetit të ketë një qasje proaktive dhe të ndërtojë bashkëpunim adekuat ndërinstitucional, në mënyrë që t'i identifikojë rastet e korrupsionit dhe t'i hetojë ato.

45. Kohëzgjatja e një rasti penal mund të jetë një ndër arsytet pse qytetarët e shohin me skepticizëm punën e Prokurorit të Shtetit. Kjo situatë vjen për disa arsye.
46. Fillimisht, “arsyeshmëria” ligjore e trajtimit të rasteve të korrupsionit prek një periudhë konsiderueshëm të gjatë. Afatet e hetimeve mund të shkojnë deri në tri (3) vjet, derisa ka një sërë procedurash për gjykimin e një rasti në shkallë të parë, pa përfshirë procedurën e apelimit të rasteve në instanca më të larta³⁴.
47. E dyta është se në gjykatë, për shkak të ngarkesës së sistemit gjyqësor me lëndë, mungesës së efikasitetit të gjyqtarëve, problemeve të tjera procedurale etj., zvarritet trajtimi i rasteve. Themelimi i Departamentit Special supozohet se kishte për qëllim ngritjen e efikasitetit. Megjithatë, afati kohor për trajtimin e rasteve vazhdon të mbetet konsiderueshëm i lartë. Mesatarja e kohëzgjatjes së rasteve të trajtuara është 894 ditë, duke treguar një periudhë relativisht të gjatë pritjeje për shpalljen e aktgjykimit³⁵.
48. Rastet e korrupsionit që përfundojnë me një aktgjykim dënues, duhet të shqiptojnë dënime që përputhen me qëllimet e dënimit. Sipas Ligjit, qëllimet e dënimit janë: 1) të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, 2) t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, **3) të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale** dhe 4) të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit³⁶.
49. Një ndër problemet kryesore që lindin në praktikë është politika ndëshkimore joadekuate, sepse, ashtu siç u theksua më lart, qëllimi i dënimit duhet t'i ngërthejë disa elemente. Për këtë arsye, Gjykata Supreme ka miratuar Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore, të cilin po ashtu e ka përditësuar, në mënyrë që gjyqtarët të shqiptojnë dënime adekuate³⁷. Në raport me rastet e korrupsionit, Gjykata Supreme ka miratuar një udhëzues të veçantë për Politikën Ndëshkimore në rastet e korrupsionit³⁸. Në po këtë udhëzues theksohet se ndjekja dhe gjykimi i korrupsionit është përpjekje e vështirë dhe shumë sfiduese e kjo vështirësi vjen për shkak të natyrës së fshehtë të korrupsionit dhe, në shumicën e rasteve, mosparaqitjes së individëve si viktimë potenciale, të cilat do të jepnin informacion rreth akteve korruptive që do të përdoreshin për inicim të hetimeve³⁹.

³⁴ Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale. Neni 157.

³⁵ Krasniqi Z. dhe Smajli, F. “Politika Ndëshkimore në Krimet “Speciale””. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Faqe 14. Prishtinë, dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/12/Politika-ndeshkimore-ne-krimet-speciale.pdf>).

³⁶ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 44.

³⁷ “Udhëzues për Politikën Ndëshkimore”. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 2018. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). “Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit”. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Prishtinë, nëntor 2024. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/337_Udhezuesi%20per%20matjen%20e%20denimit_Nentor%202024.pdf).

³⁸ “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”. Gjykata Supreme e Kosovës. Qershor 2021. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/98248_UDHEZUESI%20PER%20VEPRAT%20E%20KORRUPSIONIT-10%20qershor%202021.pdf).

³⁹ Po aty, fq. 1.

50. Megjithatë, sipas analizave të vazhdueshme të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), që ka monitoruar zbatimin e këtyre udhëzuesve, tregojnë për mosrespektim të tyre në aktgjykimet e gjykatave⁴⁰.
51. Mosshqiptimi i dënimeve adekuate për korrupsion përçon një mesazh negativ te qytetarët se rastet e korrupsionit janë, në njëfarë forme, duke u amnistuar nga sistemi i drejtësisë. Për këtë arsye, me qëllim të luftimit efikas të korrupsionit dhe rritjes së besimit të qytetarëve në aktgjykimet e gjykatave, është shumë e rëndësishme që caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimeve në rastet e korrupsionit të jetë i bazuar në dispozitat ligjore që flasin për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, si dhe me Udhëzuesit e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore⁴¹.
52. Për më tepër Avokati i Popullit thekson se një qasje që shpesh harrohet dhe është e rëndësishme është vëmendja që duhet t'u kushtohet viktimave që kanë pësuar dëm për shkak të veprës penale korruptive.
53. Avokati i Popullit rikujton se Kodi i Procedurës Penale, në nenin 19, përcakton se *i dëmtuari ose viktim*a është personi që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtimin fizik, mendor ose emocional, apo humbjen ekonomike të shkaktuar nga vepra penale, si dhe anëtarët e familjes së personit, vdekja e të cilit është shkaktuar drejtpërdrejt nga vepra penale dhe të cilët kanë pësuar dëm si rezultat i vdekjes së tij.
54. Problematika e rasteve të korrupsionit është se shpesh nuk mund të gjendet një viktimë direkte, sepse veprimet korruptive ndonjëherë ndikojnë që shkelja e të drejtave të njeriut të jetë e shtrirë në një numër më të madh njerëzish, të cilët edhe mund të mos e dinë pasojën e shkaktuar nga kjo vepër penale.
55. Megjithatë, e rëndësishme është që, ashtu siç kërkohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), çdo shtet duhet *“të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme, në përputhje me parimet e ligjit të tij të brendshëm, për të siguruar që subjektet ose personat që kanë pësuar dëme si rezultat i një akti korrupsioni kanë të drejtë të fillojnë procedura ligjore kundër atyre përgjegjës për atë dëm”*⁴². Pra, neni 35 i UNCAC-së i kushton vëmendje të veçantë rolit të palëve private, veçanërisht viktimave të korrupsionit, duke krijuar bazën për një qasje që e vendos viktimën në qendër të përpjekjeve për luftimin e korrupsionit. Duke qenë se UNCAC-ja ka shtrirje globale, ky nen përcakton standardet minimale ndërkombëtare lidhur me të drejtën e personave që kanë pësuar dëm nga korrupsioni, për të kërkuar mbrojtje juridike dhe kompensim përmes procedurave ligjore.

Mekanizmat për sinjalizimin e korrupsionit dhe shkeljeve të tjera

56. Inkurajimi dhe lehtësimi i sinjalizimit, veçanërisht përmes ofrimit të mbrojtjes efektive ligjore dhe udhëzimeve të qarta mbi procedurat e raportimit, mund t'u ndihmojë autoriteteve ta monitorojnë zbatimin e ligjit dhe t'i zbulojnë shkeljet e legjislacionit kundër korrupsionit. Ofrimi i mbrojtjes së efektshme për sinjalizuesit mbështet një kulturë të hapur organizative, ku punonjësit jo vetëm që janë të informuar se si të raportojnë, por

⁴⁰ Krasniqi Z. dhe Smajli, F. “Politika Ndëshkimore në Krimet “Speciale””. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/12/Politika-ndeshkimore-ne-krimet-speciale.pdf>).

⁴¹ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Nenet 69 dhe 70.

⁴² Shih Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, neni 35.

edhe kanë besim në procedurat e raportimit. Mbrojtja e sinjalizuesve në sektorin publik dhe privat nga hakmarrja për raportimin në mirëbesim të dyshimeve për korrupsion dhe forma të tjera të shkeljes është pjesë thelbësore e përpjekjeve për ta luftuar korrupsionin⁴³.

57. Mbrojtja e sinjalizuesve në Kosovë rregullohet përmes Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS), i cili pason Ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve.⁴⁴ LMS-ja është vlerësuar si një ligj i avancuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare⁴⁵. Përpos LMS-së, Qeveria ka miratuar edhe Rregulloren për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit. Po ashtu, Ministria e Drejtësisë ka publikuar edhe dy udhëzues në fushën e sinjalizimit: Udhëzuesin për Mbrojtjen e Personave që Raportojnë për Interes Publik, Detyrimet e Punëdhënësve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve nga Aktet e Dëmshme dhe të Drejtat e Sinjalizuesve për Mbrojtje Gjyqësore, si dhe Udhëzuesin për Mënyrën e Kryerjes së Hetimit Administrativ.⁴⁶
58. Sipas LMS-së, neni 3.1.1.5, secili person në kontekst të marrëdhënies së punës, në sektorin publik apo privat, përfshirë edhe sektorin joqeveritar, mund të raportojë shkeljet. Ligji e ka definuar edhe kuptimin e personit në kontekst të marrëdhënies së punës.
59. LMS-ja ka ndërtuar një sistem të strukturuar të sinjalizimit, i cili aplikohet si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat. Qëllimi i tij është mundësimi i sinjalizimit në këta sektorë dhe mbrojtja e sinjalizuesve nga hakmarrja. LMS-ja ka theksuar se raportimi apo shpalosja në interes publik është e mbrojtur kur bëhet për shkak se shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet, personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështojë në përmbushjen e ndonjë detyrim ligjor etj.⁴⁷
60. Ajo që ka nevojë të theksohet është se sinjalizuesi duhet të besojë se informacionet e raportuara janë të vërteta. Ligji përdor termin e “*besimit të arsyeshëm*”, që do të thotë se, në bazë të informacionit që jep dhe beson se është i vërtetë dhe në interes të publikut, një person i arsyeshëm do të arrinte në përfundimin se po ndodh, ka ndodhur ose pritet të ndodhë një shkelje. “*Besimi i arsyeshëm*” nuk është i njëjtë me “*provën*”, term juridik që nënkupton fakte që shkojnë përtej dyshimit se diçka ka ndodhur. Andaj, prej personit që raporton nuk priten prova në këtë kuptim⁴⁸.

⁴³ “G20 Anti-Corruption Action Plan Protection of Whistleblowers - Protection of Whistleblowers”. (Shih linkun:

<https://nazaha.gov.sa/Media/Posts/OECD%20Study%20on%20Whistleblowers%20Protection%20Framework%20C%20Compendium%20of%20Best%20Practices%20and%20Guiding%20Principles%20for%20Legislation.pdf>)

⁴⁴ Ligji nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve; Ligji nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve.

⁴⁵ “Kosovo* 2019 Report”. Komisioni Evropian. Faqe 22-23. Bruksel, 29 maj 2019. (Shih linkun:

https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/85bb4cd1-fbe1-47b3-8914-7f606f1ede37_en?filename=20190529-kosovo-report.pdf).

⁴⁶ “Udhëzues për Mbrojtjen e Personave që Raportojnë në Interes Publik, Detyrimet e Punëdhënësve për Mbrojtjen e Sinjalizuesve nga Aktet e Dëmshme dhe të Drejtat e Sinjalizuesve për Mbrojtje Gjyqësore”.

Ministria e Drejtësisë. 19 shtator 2023. (Shih linkun: <https://old.unhz.eu/Dokumente/Dokumente/Udhëzues-për-mbrojtjen-e-personave-që-raportojnë-në-interes-publik-detyrimet-e-punëdhënësve-për-mbrojtjen-e-sinjalizuesve.pdf>); “Udhëzues për Mënyrën e Kryerjes së Hetimit Administrativ”. Ministria e Drejtësisë. 18 korrik 2023. (Shih linkun: <https://ushaf.net/wp-content/uploads/2023/10/UDHEZUES-PER-HETIMIN-ADMINISTRATIV.pdf>).

⁴⁷ Ligji nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 5.

⁴⁸ “Mbrojtja e Sinjalizuesve”. Këshilli i Evropës. Faqe 9. Qershor 2019. (Shih linkun: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/4227766a-735c-4ff2-a6e7-1b6362505d7d.pdf>).

61. Punëdhënësi publik, i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar, dhe punëdhënësi privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar, janë të obliguar ta caktojnë zyrtarin përgjegjës. Adresa e parë ku sinjalizuesi duhet të sinjalizojë është brenda institucionit, te zyrtari përgjegjës për trajtimin e rasteve të korrupsionit. Por, nëse ndaj tij ka dyshime se për shkak të sinjalizimit të tij ai mund t'i nënshtrohet veprimeve të dëmshme, atëherë mund të bëjë sinjalizim të jashtëm. Sinjalizimi i jashtëm, në rastin e sektorit publik, bëhet tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa në rastin e sektorit privat, bëhet tek Inspektorati i Punës. Përtej kësaj, në rrethanat e përcaktuara me Ligj, sinjalizimi mund të bëhet edhe në publik. Në secilin rast dhe në secilën fazë, sinjalizuesi duhet të njoftohet për rezultatet e rastit të sinjalizuar⁴⁹.
62. Sinjalizuesit kanë të drejtë në mbrojtje nga raportimi i shkeljeve. Gjithashtu, personi i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova lidhur me sinjalizimin apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhjeje me sinjalizuesin, ka të drejtë në mbrojtje. Kjo vlen edhe për personin që dëshmon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tyre për shkak se personi që ndërmerr veprimin e dëmshëm beson gabimisht se ai është sinjalizues ose person i lidhur me sinjalizuesin, si dhe për zyrtarin përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit⁵⁰.
63. Konfidencialiteti është njëra prej parimeve kryesore në trajtimin e rasteve të sinjalizimit. Konfidencialiteti nënkupton detyrimin për mosshpërndarjen e informacioneve te asnjë person tjetër, përfshirë edhe personin kundër të cilit sinjalizohet. Kjo për faktin që, përpos hakmarrjes, sinjalizuesit të mbrohen edhe nga çfarëdo lloj stigmatizimi. Përgjashtim këtu bëjnë vetëm rrethanat e domosdoshme dhe shumë specifike. Cenimi i konfidencialitetit sanksionohet me gjobë deri në 20.000 euro⁵¹.
64. Sipas LMS-së, mbrojtja e sinjalizuesve nga veprimet e dëmshme përfshin mbrojtjen nga shkarkimi nga puna, pezullimi nga puna ose nga një apo më shumë detyra, transferimi brenda ose jashtë institucionit publik apo subjektit privat pa pëlqimin e tij, ulja në pozitë, etj. Çdo veprim i dëmshëm ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm. Nëse ndaj një sinjalizuesi ndërmerret ndonjë veprim i dëmshëm, ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës, pa qenë i detyruar t'i shterojë mjetet juridike. Padia duhet të parashtrohet brenda gjashtë (6) muajsh nga dita kur sinjalizuesi është vënë në dijeni për veprimin e dëmshëm, por jo më vonë se tri vjet nga dita e ndërmarrjes së këtij veprimi.
65. Karakteristikë e padive që ngrihen nga sinjalizuesit është se në të gjitha rastet kur sinjalizuesi ose personi i lidhur me sinjalizuesin konsideron se ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, punëdhënësi (pra jo sinjalizuesi) e ka barrën e provës të provojë se veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje shkakore me sinjalizimin⁵². Përtej kësaj, sinjalizuesit mbrohen edhe me norma penale. Sipas Kodit Penal, ndërmarrja e veprimit të dëmshëm ndaj një sinjalizuesi kriminalizohet si vepër penale, e dënueshme me gjobë apo me burgim deri në dy vjet⁵³.
66. Në këtë mënyrë, LMS-ja ofron një mbrojtje si tërësi (holistike) për të gjithë sinjalizuesit, përdorin ata nuk keqpërdorin këtë mekanizëm. Për t'u ofruar kjo mbrojtje, duhet të ketë

⁴⁹ Ligji nr. 06/1-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Nenet 17-20.

⁵⁰ Po aty, nenet 7 dhe 8.

⁵¹ Po aty, nenet 11 dhe 27.1.1.8.

⁵² Po aty, neni 25.

⁵³ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 388.2.

një sinjalizim dhe një sinjalizues, të cilit i garantohet konfidencialiteti dhe mbrojtja nga hakmarrja. Kështu, nuk duhet përzier sinjalizimi me një raportim anonim të shkëljes. Nisur nga emërtimi i Ligjit, LMS-ja ka për qëllim mbrojtjen e sinjalizuesit, i cili qëllim nuk mund të arrihet nëse nuk dihet se kush ka sinjalizuar. Për këtë arsye, raportimi anonim nuk i referohet mbrojtjes së sinjalizuesve.

67. Me qëllim të rritjes së efikasitetit në trajtimin e rasteve të sinjalizimit, është e rëndësishme që institucionet të mundësojnë zbatim real të sistemit të sinjalizimit sipas LMS-së. Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme që zyrtarët për trajtimin e rasteve të sinjalizimit të caktohen persona të besueshëm për stafin dhe ata të trajnohen në mënyrë adekuate. Tutje, në mënyrë që të mundësohet një mbrojtje adekuate e konfidencialitetit, është e rëndësishme që të krijohen kushtet praktike për këtë, si: sirtarët e veçantë për dosje, hapësirat e sigurta etj. E gjitha për qëllimin që të rritet besueshmëria te procesi i sinjalizimit dhe rrjedhimisht edhe numri i sinjalizimeve. Po ashtu, është e rëndësishme që stafi të njoftohet me kohë për çfarëdo ndryshimi në lidhje me personin përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit. Nëse ndërrohet ky zyrtar dhe stafi nuk njoftohet, atëherë ka rrezik që sinjalizimi të bëhet në adresë të gabuar, duke u cenuar konfidencialiteti i sinjalizimit⁵⁴.
68. Raporte të caktuara tregojnë se numri i vogël i sinjalizimeve nuk lidhet me mungesën e rasteve që zyrtarët mund t'i sinjalizojnë. Kjo dëshmohet nga fakti se është evidentuar një situatë në të cilën shumë informacione pranohen nga mediat dhe OJQ-të, por nuk sinjalizohen⁵⁵.
69. Në anën tjetër, tanimë ka një dilemë në lidhje me rolin e APK-së në trajtimin e rasteve të sinjalizimit. LMS-ja thekson se APK-ja kryen hetime në rastet e sinjalizuesve brenda kompetencave që ka, derisa Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit ka kufizuar kompetencat e kësaj Agjencie në këtë fushë. Kjo çështje duhet të zgjidhet qoftë përmes një interpretimi më të gjerë të kësaj situate nga APK-ja, qoftë përmes ndryshimit dhe harmonizimit të ligjeve ndërmjet vete, duke i mundësuar APK-së përmbushjen e mandatit që ka.

Metodologjia e hulumtimit

70. Për të vlerësuar nëse ndikimet e përshkruara në literaturë dhe kornizën normative reflektohen edhe në përvojat e qytetarëve në Kosovë, u realizua anketa për të kuptuar perceptimet, përvojat dhe implikimet e korrupsionit mbi të drejtat e njeriut. Ky hulumtim ka kombinuar qasje kuantitative dhe kualitative, duke përdorur një dizajn metodologjik të integruar. Për realizimin e këtij studimi, Instituti Riinvest ka angazhuar një ekip të dedikuar me hulumtues dhe anketues në terren, të cilët kanë qenë përgjegjës për zhvillimin e anketës me qytetarët, intervistat me institucionet, analizën e të dhënave, si dhe hartimin e raportit final.

Mbledhja e të dhënave kuantitative

71. Të dhënat kuantitative janë mbledhur përmes një ankete të opinionit publik, e cila synon të masë perceptimet, përvojat dhe qëndrimet e qytetarëve lidhur me korrupsionin dhe

⁵⁴ Rezniciq, A. dhe Smajli, F. "Përmbushja e premtimit për sinjalizuesit". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Faqe 24. Prishtinë, tetor 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/permbushja-e-premtimit-per-sinjalizuesit/>).

⁵⁵ Po aty.

ndikimin e tij në të drejtat e njeriut. Anketa është realizuar në të gjitha komunat e Kosovës, ndërsa përzgjedhja e të anketuarve është bazuar në një mostër statistikisht përfaqësuese prej 1.040 qytetarësh. Kjo madhësi e mostrës siguron një marzh gabimi prej afërsisht ± 3 për qind, me një nivel besueshmërie prej 95 për qind.

72. Dizajni i mostrës është ndërtuar mbi një qasje të shtresëzuar, ku komuna përbën nivelin e parë të shtresimit, ndërsa gjinia nivelin e dytë. Shpërndarja e të anketuarve nëpër komuna është bërë në përpjesëtim me popullsinë e tyre, duke siguruar përfaqësim adekuat të zonave urbane dhe rurale. Ndërkohë, karakteristika të tjera demografike, si arsimi apo statusi i punësimit, janë mbledhur përmes vetëraportimit gjatë intervistave. Në përzgjedhjen e njësive të banimit për anketim është përdorur metoda Probability Proportional to Size (PPS). Kjo metodë siguron që shtëpitë në zonat më të mëdha të kenë po aq gjasa të përfshihen në mostër sa ato në zonat më të vogla, duke rritur barazinë e përzgjedhjes. Po ashtu, kjo qasje e bën më efikase planifikimin e punës në terren, pasi përcaktohet paraprakisht numri i intervistave që kryhen në çdo zonë të përzgjedhur rastësisht.
73. Pasi është identifikuar shtëpia, përzgjedhja e respondentit brenda saj bëhet sipas tri kriterëve: personi duhet të jetë 18 vjeç ose më i madh, të ketë jetuar në atë shtëpi për të paktën gjashtë muaj dhe të mos ketë pengesa shëndetësore apo kognitive që e pengojnë pjesëmarrjen. Në rastet kur më shumë se një person në shtëpi i ka plotësuar këto kushte, personi është përzgjedhur rastësisht përmes metodës së “ditëlindjes më afër datës së intervistimit”.
74. Anketa është zhvilluar me intervista ballë për ballë në terren, ndërsa punën e anketuesve e kanë monitoruar mbikëqyrës të caktuar nga menaxheri i anketës. Për të garantuar cilësi të lartë të mbledhjes së të dhënave, janë përdorur disa mekanizma verifikimi, përfshirë telefonata të kontrollit, përmes të cilave rreth 20 për qind e intervistave janë verifikuar nga mbikëqyrësit për të siguruar që intervistat janë kryer realisht dhe me personat e saktë. Gjithashtu, është kryer kontroll logjik i të dhënave për të identifikuar përgjigjet kontradiktore.
75. Pas përfundimit të kontrollit të cilësisë, të dhënat janë koduar në programin Excel dhe më pas janë analizuar në SPSS. Analiza është kryer kryesisht përmes statistikave përshkruese dhe tabelave të kryqëzuara duke u fokusuar në lidhjet midis variablave të ndryshme të perceptimit dhe përvojës së korrupsionit.

Intervistat gjysmë të strukturuar

76. Përtej komponentit kuantitativ, studimi është pasuruar me të dhëna cilësore të mbledhura përmes intervistave gjysmë të strukturuar, me institucione kyçe të përfshira në luftimin e korrupsionit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve publike. Pyetësorët janë hartuar individualisht për të gjitha institucionet e përfshira gjatë intervistimit, duke u fokusuar në tre kapituj kryesor: (i) ndikimin e korrupsionit në të drejtat e njeriut dhe sektorët më të prekur nga korrupsioni; (ii) mekanizmat monitorues dhe parandalues të korrupsionit në institucionet përkatëse; (iii) rekomandime rreth ndryshimeve të nevojshme që ndikojnë në parandalimin dhe luftimin e rasteve të korrupsionit në vend. Ekipi i hulumtimit hartoi versionet fillestare të pyetësorëve institucionalë, të cilat u diskutuan me Zyrën e Avokatit të Popullit. Bazuar në komentet dhe rekomandimet e tyre, pyetësorët u finalizuan.

77. Hulumtuesit e Institutit Riinvest dhe përfaqësues të Zyrës së Avokatit të Popullit janë takuar personalisht me përfaqësues të 19 institucioneve dhe organizatave, përfshirë organet e pavarura mbikëqyrëse, agjencitë e sundimit të ligjit, institucionet gjyqësore, organizatat e të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile. Intervistat kanë shërbyer për të thelluar kuptimin e gjetjeve të anketës nga një prizëm tjetër - ai institucional, përtej perceptimit të qytetarëve rreth funksionalitetit të mekanizmave ekzistues institucionalë. Të dhënat cilësore të intervistave janë analizuar në mënyrë tematike dhe janë ndërthurur me rezultatet e anketës.

Rezultatet nga anketa me qytetarë

78. Ashtu siç u tha deri tani, korrupsioni në Kosovë mbetet një nga sfidat për zhvillimin demokratik, mirëqenien qytetare dhe funksionimin e shtetit ligjor. Përmasat e tij janë të dukshme si në perceptimet e publikut, ashtu edhe në përvojat konkrete të qytetarëve në marrëdhëniet e përditshme me institucionet publike. Për ta kuptuar më qartë këtë realitet, Instituti Riinvest ka zhvilluar një anketë me qytetarë, e cila synon të masë se si definohet korrupsioni, cilat fusha perceptohen si më të ekspozuara dhe si ndikon ai në të drejtat themelore të njeriut.

79. Kur qytetarët u pyetën rreth veprimeve të caktuara që ata i konsideronin si korrupsion, përgjigjet e tyre dhanë një pamje të qartë mbi mënyrën se si shoqëria e sheh këtë fenomen (Tabela 1). Shumica dërrmuese e të anketuarve e identifikojnë korrupsionin si një shkelje të besimit publik dhe një formë abuzimi të pozitës zyrtare, pavarësisht nëse ai manifestohet përmes ryshfeteve të vogla në jetën e përditshme apo deri te ndërhyrjet në nivele të larta në politikë dhe administrata.

Tabela 1 - Perceptimi i qytetarëve mbi veprimet që konsiderohen si korrupsion (si %).

Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2025

	Po	Jo	Nuk e di
Dhënia e një dhurate mjekut për të marrë kujdes të veçantë shëndetësor.	74.8	22.7	2.5
Një mësues/profesor që kërkon para ose dhuratë për t'i trajtuar më mirë nxënësit/studentët.	91.3	7.3	1.4
Ndërhyrja te zyrtarët e lartë për të punësuar të afërmit.	90.2	6.7	3.1
Kërkesa personale te një zyrtar komunal për të marrë leje ndërtimi.	83.2	12.5	4.3
Dhënia e parave policit për të shmangur gjobën ose për të mos ia konfiskuar lejen e vozitjes.	95.6	3.3	1.1
Shfrytëzimi i pozitës zyrtare për kryerjen e punëve private.	88.6	7.2	4.2
Ofrimi i informacioneve zyrtare te persona pa qasje në to, në këmbim të përfitimeve personale.	90.2	4.3	5.5
Marrja e parave nga zyrtarët për të fshehur ose ulur vlerën e tatimeve.	94.5	2.6	2.9
Dhënia e parave për të mbështetur fushatat e partive politike.	87.7	6.7	5.6
Pagesa shtesë për një avokat, me qëllim që të mbyllet rasti i një të dyshuari.	88.4	6.8	4.8
Dhënia e parave të gatshme ose ofrimi i një shërbimi për të “përsheptuar” procedurat administrative.	91.2	6.7	2.1

Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2025

80. Veprimet më të zakonshme të ryshfetit dhe abuzimit të pushtetit, si dhënia e parave një polici për të shmangur një gjobë apo marrja e parave nga zyrtarët për të ulur tatimet, u perceptuan si korrupsion nga mbi 94 për qind e të anketuarve. Në mënyrë të ngjashme, praktikat e nepotizmit dhe ndërhyrjet politike – punësimi i të afërmeve përmes lidhjeve

apo financimi i fushatave partiake – u konsideruan të dyja si forma të qarta të korrupsionit nga mbi 85 për qind e të anketuarve. Megjithatë, kur bëhet fjalë për praktika të institucionalizuara në kulturën shoqërore, si dhuratat për mjekët në këmbim të kujdesit më të veçantë, niveli i njohjes si korrupsion bie në rreth 75 për qind. Kjo tregon se ende ekziston një hapësirë gri mes asaj që konsiderohet si “shenjë mirënjohjeje” dhe asaj që përbën shkelje të qartë etike dhe ligjore. Ky fenomen lidhet me atë që Transparency International⁵⁶ e përkufizon si *facilitation payments* – pagesa të vogla të bëra për të siguruar apo përsheptuar një shërbim për të cilin qytetari tashmë ka të drejtë, por që, në praktikë, shihet si i varur nga “shtesat” joformale. Ky dallim i paqartë është një tregues i rëndësishëm për kulturën e tolerancës që, shpesh pa vetëdije, lejon korrupsionin të mbijetojë në marrëdhëniet e përditshme mes qytetarëve dhe institucioneve.

81. Rezultatet e anketës tregojnë se korrupsioni shihet nga qytetarët e Kosovës si një pengesë e madhe për funksionimin normal të shërbimeve dhe zhvillimin shoqëror e ekonomik. Për shumicën, ndikimi është i thellë dhe shpesh i përshkruar si “shumë i madh”, sidomos në sektorë që lidhen ngushtë me të drejtat themelore të njeriut (Figura 1).




Figura 1 - Aspektet ku korrupsioni perceptohet se ka ndikimin më të madh negativ (si %).
Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2025

82. Sistemi gjyqësor dhe shëndetësor dalin në krye të listës si më të cenuarit. Rreth tre të katërtat e të anketuarve besojnë se korrupsioni prek rëndë kujdesin shëndetësor, ndërsa më tepër se aq e shohin sistemin gjyqësor si fushën ku ndikimi është më i thellë. Ky perceptim mbështetet edhe nga Puls i Opinioneve Publikë⁵⁷, ku kujdesi shëndetësor (18.6%) dhe gjykatat (36.5%) renditen ndër sektorët ku qytetarët besojnë se korrupsioni mbizotëron në shkallë të gjerë. Ndërkohë, sistemi gjyqësor shihet si edhe më i ekspozuar. OSBE-ja, përmes monitorimit të 52 rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë midis 2021 dhe 2024, evidentoi vonesa të gjata procedurale, mungesë konsistence në vendime dhe dështim për të ofruar përgjegjshmëri efektive⁵⁸. Po ashtu, një raport i

⁵⁶ <https://www.transparency.org/en/corruptionary/facilitation-payments>

⁵⁷ UNDP. 2024. Public Pulse Brief XXVI. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.
<https://www.undp.org/kosovo/publications/public-pulse-brief-xxvi>

⁵⁸ OSCE. 2024. Raporti mbi monitorimin e proceseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor: Vlerësimi i efektivitetit të reagimit të gjyqësorit ndaj krimit të rëndë të organizuar dhe korrupsionit (korrik 2021 – mars

GLPS-së për vitin 2024 thekson se trajtimi gjyqësor i rasteve të korrupsionit mbetet i ngadaltë dhe shpesh joefektiv, duke ushqyer bindjen publike se gjyqësori është i kapur dhe i politizuar⁵⁹.

83. Arsimi renditet i treti duke sinjalizuar shqetësime të thella se praktikatat e ryshfetit ose favorizimit në shkollim që po minojnë barazinë në qasje dhe cilësinë e arsimit, duke ndikuar drejtpërdrejt te gjeneratat e reja. Edhe në anketën e perceptimit të qytetarëve e USAID-it⁶⁰, të vitit 2021, për korrupsionin në komuna, 83 për qind e të anketuarve mendonin se ka korrupsion në universitetet publike (35% në shkallë të mesme dhe 17% në shkallë të gjerë), por që paraqet një rënie në krahasim me 88 për qind që menduan të njëjtën gjë në vitin 2020.
84. Në fushën e zhvillimit ekonomik, qytetarët theksojnë ndikimin e madh të korrupsionit, duke reflektuar perceptimin e gjerë se ai paraqet pengesë për investime, hapjen e bizneseve të reja dhe rritjen e vendeve të punës. Megjithatë për hapjen e bizneseve të reja (53.5%) dhe investimet nga jashtë (56.3%) përqindja e atyre që flasin për ndikim shumë të madh është më e ulët, prapëseprapë kjo mbetet një shifër e konsiderueshme dhe dëshmi se korrupsioni shihet si një faktor që dekurajon ndërmarrësinë. Në shërbimet administrative – qofshin ato lokale (64.3%) apo qendrore (64.8%) – korrupsioni perceptohet si një pengesë e fortë, por jo në të njëjtat nivele dramatike si në drejtësi, shëndetësi dhe arsim. Për shembull, edhe sipas Pulsit Publik⁶¹, perceptimi i korrupsionit në administratën qendrore ka rënë nga 36.7 për qind (2019) në vetëm 17 për qind (2024), ndërsa te komunat nga 25.8 për qind (2019) në 15.9 për qind (2024). Ndërkaq, kur kalojmë nga perceptimet te përvojat e drejtpërdrejta ose të tërthorta, shfaqet një realitet edhe më shqetësues mbi shtrirjen e praktikave korruptive në kontaktet e përditshme të qytetarëve me institucionet publike (Figura 2).

2024). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

https://www.osce.org/files/f/documents/1/8/570177_0.pdf

⁵⁹ Group for Legal and Political Studies (GLPS). 2025. Institutional Treatment of Corruption Cases during 2024.

⁶⁰ USAID. 2021. Anketa e perceptimit të qytetarëve për korrupsionin dhe transparencën në prokurimin publik.

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.

⁶¹ UNDP. 2024. Public Pulse Brief XXVI. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.

<https://www.undp.org/kosovo/publications/public-pulse-brief-xxvi>




Figura 2 - Përvoja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e qytetarëve me korrupsion sipas sektorëve (si %). Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2025

85. Në krye të listës del zyra e lejeve të vozitjes, ku rreth 32 për qind e të anketuarve raportojnë përvojë të drejtpërdrejtë me ryshfet gjatë procedurave për marrjen e patentë-shoferëve. Menjëherë pas saj vijnë gjyqtarët dhe prokurorët (27%) dhe policia (25%), duke dëshmuar se edhe sistemi i drejtësisë dhe i rendit përballet me praktika të korrupsionit në përvojat konkrete të qytetarëve. Ky dallim midis perceptimit dhe përvojës është i njohur edhe në nivel ndërkombëtar. Për shembull, sipas Eurobarometrit Special mbi qëndrimet e qytetarëve ndaj korrupsionit në BE (2024)⁶², shumica e të anketuarve (61%) e konsiderojnë korrupsionin të papranueshëm dhe 68 për qind besojnë se është i përhapur në vendin e tyre, por vetëm 27 për qind ndihen personalisht të prekur nga ai në jetën e përditshme.
86. Administrata publike nuk mbetet prapa: zyrtarët e shërbimeve publike (24.2%), Dogana (22.7%), përfaqësuesit e zgjedhur komunalë (22.6%) dhe zyrtarët e tatimeve (21.5%) shfaqen si fusha ku qytetarët shpesh përballen me kërkesa korruptive. Po ashtu, zyrtarët komunalë (20.1%), mjekët, infermierët (20.5%) dhe zyrtarët e kadastrës (19.5%) shtojnë një tjetër dimension, duke treguar se edhe prona dhe regjistrimi i saj nuk janë immune ndaj abuzimeve. Në anën tjetër, përqindja më e ulët, por jo e parëndësishme, është raportuar për mësuesit dhe profesorët (14.8%).
87. Për t'i kuptuar më mirë përmasat e korrupsionit dhe perceptimin e tij në shoqëri, qytetarëve u janë drejtuar me një sërë pyetjesh që synonin të matnin se si ata e përcaktojnë këtë fenomen, në cilat fusha e shohin ndikimin më të madh dhe si e përjetojnë atë në kontaktet e përditshme me institucionet publike (Tabela 2).

⁶² <https://europa.eu/eurobarometer/surveys/detail/3217>

Tabela 2 Institucionet ku qytetarët kanë dhënë dhuratata, favore ose para shtesë (12 muajt e fundit). Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2025

	Jo	Po
Mjekë	87.6	12.4
Zyrtarë të policisë	88.3	11.7
Infermierë	91.3	8.7
Zyrtarë të Agjencisë së Regjistrimit të Lejeve të Vozitjes	92.3	7.7
Zyrtarë të doganave	92.8	7.2
Zyrtarë komunale	93.3	6.7
Zyrtarë të shërbimeve publike	94.0	6.0
Mësues / Profesorë	94.0	6.0
Zyrtarë të kadastrës	95.7	4.3
Administrata komunale	96.1	3.9
Zyrtarë të tatimeve (ATK)	96.9	3.1
Gjyqtarë / Prokurorë	97.0	3.0
Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	97.6	2.4

88. Të dhënat tregojnë se, megjithëse shumica e qytetarëve nuk kanë raportuar dhënie ryshfeti ose dhuratash në vitin e fundit, një pjesë domethënëse e tyre kanë pranuar se u është dashur të jepnin “diçka shtesë” në kontakte me sektorë të ndryshëm publik. Në raportin më të fundit të Indeksit të Sistemit Kombëtar të Integritetit për Kosovën⁶³, sektori publik vlerësohet me vetëm 62 nga 100 pikë, duke reflektuar boshllëqe serioze në pavarësi, llogaridhënie dhe integritet. Pavarësisht se korniza ligjore konsiderohet e avancuar, zbatimi mbetet i mangët, sidomos për shkak të ndikimit politik në emërimet e zyrtarëve të lartë dhe mungesës së sanksioneve efektive. Raporti thekson se korrupsioni vazhdon të perceptohet si i përhapur, ndërsa ndëshkimi i tij është shpesh i pamjaftueshëm.

89. Shëndetësia del si fusha më e ndjeshme: më shumë se 12 për qind e qytetarëve kanë dhënë para ose dhuratata për mjekët dhe rreth 9 për qind për infermierët. Kjo përqindje është më e larta ndër të gjitha kategoritë, duke konfirmuar se praktikat joformale për kujdes më të mirë apo trajtim më të shpejtë janë ende të përhapura dhe perceptohen si pjesë e përditshmërisë së qytetarëve. Ky rezultat është veçanërisht shqetësues pasi prek drejtpërdrejt të drejtën themelore për kujdes shëndetësor pa diskriminim. Këtë e konfirmojnë edhe studimet që theksojnë se shërbimet shëndetësore janë një nga shqetësimet kryesore të qytetarëve në Kosovë. Shqetësimi bazohet në nivelet historikisht të ulëta të financimit publik për shëndetin publik dhe keqmenaxhimit kronik në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, gjë që i ka detyruar qytetarët të kërkojnë zgjidhje te operatorët privatë shëndetësorë⁶⁴.

90. Policia renditet gjithashtu lart, me rreth 12 për qind të qytetarëve që kanë dhënë ryshfet për të shmangur gjoba ose procedura të tjera ligjore. Ky tregues vë në pah një problem të vazhdueshëm me integritetin e forcave të rendit, duke minuar besimin publik në një prej

⁶³ Transparency International Kosova. 2024. National Integrity System Assessment Kosovo. Mars 2024.: <https://files.transparencycdn.org/images/2023-Kosovo-NIS-Eng.pdf>

⁶⁴ Instituti Demokratik i Kosovës & Transparency International Kosovo. 2018. Kapja e shtetit në Kosovë: Tregtimi i shëndetit publik për përfitime private. <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2018/09/26-Helath-Sector-State-Capture-ALB.pdf>

institucioneve që duhet të garantojë barazi dhe drejtësi. Në këtë linjë, Hartëzimi i Rrezikut nga Korrupsioni ⁶⁵e vlerëson Policinë e Kosovës me pikëzim 30 për qind, duke e identifikuar si një institucion me nivel mesatar të lartë rreziku për korrupsion. Ky vlerësim i referohet probabilitetit relativ të shfaqjes së korrupsionit në funksionet e saj (p.sh. gjrobat, kontrollet, kontaktet me qytetarët) dhe jo përqindjes së zyrtarëve të përfshirë në praktika korruptive. Kurse në arsim, rreth 6 për qind e qytetarëve raportojnë se u është dashur të jepnin pagesë shtesë apo dhuratë mësuesve/profesorëve, shpesh për kalimin e provimeve ose trajtim më të favorshëm.

91. Institucione të tjera me nivele të dukshme korrupsioni të raportuara përfshijnë zyrat e patentë-shoferëve (7.7%), doganat (7.2%), zyrtarët komunalë (6.7%) dhe zyrtarët e shërbimeve publike (6.0%). Megjithatë këto përqindje duken më të ulëta, ato përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm qytetarësh dhe sugjerojnë se korrupsioni nuk është i kufizuar vetëm në sektorët më të ekspozuar, por ka shtrirje horizontale në shumë nivele të administratës.
92. Sektori i drejtësisë – gjyqtarë dhe prokurorë – shënon 3 për qind të rasteve të raportuara, ndërsa në administratën qendrore, tatime, kadastra dhe institucione të tjera përqindjet lëvizin mes 2 dhe 4 për qind. Edhe pse në dukje më të ulëta, këto shifra nuk duhen nënvlerësuar: korrupsioni në këto fusha ka ndikim shumë të madh, pasi lidhet me sigurinë juridike, pronësore dhe ekonomike të qytetarëve.
93. Një gjetje veçanërisht domethënëse është se edhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (2.4%) përmendet nga qytetarët si institucion ku është dhënë pagesë apo dhuratë shtesë, çka reflekton një gjetje jo të mirë, madje edhe në institucionet që kanë mision primar luftën kundër korrupsionit.
94. Kur shohim rezultatet e pyetjes mbi qëllimin kryesor të dhënies së ryshfetit ose dhuratës, shohim se një pjesë e madhe e qytetarëve, afro 40 për qind, kanë deklaruar se nuk e mbajnë mend ose nuk kanë specifikuar një arsye të qartë, çka mund të reflektojë disa faktorë të mundshëm, si fjala vjen, vështirësinë për ta pranuar hapur përvojën, pasigurinë në kategorizimin e situatës, ose dëshirën për të shmangur përgjigje të drejtpërdrejtë në një temë kaq të ndjeshme. Kurse, nga ata që kanë dhënë një përgjigje të qartë, tri arsye kryesore dominojnë: për të përshpejtuar procedurat (15.2%), për të finalizuar procedurën (12.7%), dhe për të marrë trajtim ose shërbim më të mirë (12.1%) (Tabela 3).

Tabela 3 - Qëllimi i pagesës ose dhuratës së fundit ndaj një zyrtari publik. Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2025

Qëllimi i pagesës/dhuratës	Përqindja
Nuk e mbaj mend	40%
Për të përshpejtuar procedurën	15%
Për të finalizuar procedurën	13%
Për të marrë trajtim ose shërbim më të mirë	12%
Për të shmangur pagesën e një gjobe	7%
Tjetër (ju lutem specifikoni)	5%

⁶⁵ Agjencia Kundër Korrupsionit (APK). 2024. Hartëzimi i rrezikut nga korrupsioni në administratën publike dhe ndërmarrjet shoqërore në Kosovë. Gusht 2024. https://apk-rks.net/wp-content/uploads/2024/12/2024-Gusht-Raporti-Hartezimi-i-Rrezikut-nga-Korrupsioni_ALB_compressed.pdf

Pa qëllim specifik	4%
Për të ulur koston e procedurës	2%
Për të marrë informacion ose qasje	2%

95. Në përmbledhje, kjo dëshmon se korrupsioni shihet më së shumti si një instrument për të kapërcyer barriera sistemike – procedura të gjata, shërbime të pabarabarta, ose trajtim joefikas nga institucionet publike. Kjo mund të lidhet me faktin se qytetarët shpesh normalizojnë vonesat administrative ose pagesat joformale si pjesë të përditshmërisë, një dukuri që në literaturë njihet si ‘petty corruption’. Sipas Transparency International⁶⁶, kjo përkufizohet si “abuzimi i përditshëm i pushtetit të besuar nga zyrtarët publikë të niveleve të ulëta dhe të mesme në ndërveprimet e tyre me qytetarët e zakonshëm”. Edhe pse bëhet fjalë për pagesa të vogla, kostoja kumulative e tyre është e konsiderueshme kur shihet në shkallë kombëtare ose globale. Për më tepër, siç theksohet nga raporti, ryshfetet e vogla zakonisht ndodhin në pikën e ofrimit të shërbimit publik, duke ndikuar drejtpërdrejt në qasjen e qytetarëve në shërbime dhe duke minuar standardin e jetesës së tyre.
96. Ky perceptim jo vetëm që dëmton barazinë para ligjit, por gjithashtu krijon një rreth vicioz, ku qytetarët përpiqen ta justifikojnë korrupsionin si “zgjidhje praktike”, ndërkohë që në realitet ai forcon kulturën e pandëshkueshmërisë dhe cenon të drejtat e tyre themelore. Për më tepër, një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve (13.8%) theksuan se zyrtari publik ua bëri të kuptonin në mënyrë indirekte se pritej një pagesë shtesë, ndërsa rreth tetë për qind raportuan se ka pasur një kërkesë të qartë dhe eksplicite. Kjo sugjeron se korrupsioni në shumë raste nuk është i artikuluar hapur, por funksionon nëpërmjet gjeesteve, insinuatave dhe mekanizmave joformalë që e bëjnë më të vështirë adresimin e tij.
97. Në vijim të analizës mbi përmasat dhe format e korrupsionit, është me rëndësi të shihet edhe ana e raportimit, pra mënyra se si qytetarët reagojnë kur përballen me kërkesa për ryshfet apo dhurata. Nëse pyetjet e mëparshme treguan se korrupsioni është i pranishëm në sektorë të ndryshëm dhe shpesh perceptohet si pengesë serioze për të drejtat e njeriut, të dhënat mbi raportimin zbulojnë një tjetër dimension të problemit: klimën e mosbesimit dhe hezitimit për ta denoncuar atë.
98. Të dhënat tregojnë se niveli i raportimit të rasteve të korrupsionit në Kosovë mbetet jashtëzakonisht i ulët, duke ngritur shqetësime serioze mbi funksionalitetin e mekanizmave ekzistues të denoncimit dhe mbi nivelin e besimit të qytetarëve te institucionet shtetërore. Nëse përjashtojmë ata që nuk janë përballur me kërkesa për ryshfet, rezulton se vetëm rreth 3 për qind e qytetarëve që kanë pasur përvojë me korrupsion e kanë raportuar atë, çka tregon për një hendek të thellë mes përvojës së korrupsionit dhe gatishmërisë për ta denoncuar atë (Figura 3). Ky rezultat është domethënës, por jo i izoluar: sipas Special Eurobarometer 470⁶⁷, mbi 8 në 10 evropianë (81%) që kanë përjetuar ose dëshmuar korrupsion nuk e kanë raportuar atë, ndërsa vetëm 18 për qind kanë ndërmarrë hapa për ta denoncuar.

⁶⁶ Chêne, M. 2019. Successful approaches to tackle petty corruption. Transparency International Anti-Corruption Helpdesk. <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/kproducts/Fighting-petty-corruption-2019.pdf>

⁶⁷ European Commission. 2017. Special Eurobarometer 470 – Corruption. Directorate-General for Migration and Home Affairs, DG Communication, TNS Opinion & Social.




Figura 3 - Niveli i raportimit të korrupsionit në Kosovë sipas qytetarëve. Burimi: Anketa e Institutit Riinvest 2025

99. Nga ana tjetër, 36 për qind e qytetarëve kanë pohuar se, edhe pse janë përballur me një kërkesë të tillë, nuk e kanë raportuar. Arsyeja më e përhapur është mosbesimi te institucionet: rreth 14 për qind e qytetarëve janë të bindur se “asgjë nuk do të ndryshojë” edhe nëse ata raportojnë.
100. Frika nga hakmarrja përmendet nga afër 4 për qind e qytetarëve, duke treguar se raportimi shihet si një akt që mund të sjellë pasoja personale, qofshin ato ligjore, sociale apo ekonomike. Ndërsa, një tjetër pjesë e konsiderueshme e të anketuarve thonë se nuk raportuan, sepse “ishte një problem i vogël” (8.6%) ose “nuk dinin ku të raportonin” (8.3%). Të dyja këto arsye tregojnë mungesë informimi dhe ndërgjegjësimi: qytetarët ose nuk e shohin korrupsionin si të vlefshëm për t’u adresuar, ose nuk e kanë të qartë për institucionet dhe procedurat ku mund të bëjnë denoncimin.
101. Edhe pse numri i rasteve të raportuara është shumë i kufizuar, nga të dhënat kuptojmë se cilat institucione perceptohen si adresat kryesore për denoncim. Vetëm 19 raste raportimi janë regjistruar nga të gjithë të anketuarit, gjë që tregon një nivel tejet të ulët të aktivizimit qytetar. Ndër këto raste, policia del si institucioni ku janë raportuar më shpesh praktikatat e korrupsionit (36.8% e rasteve). Ky konstatim përputhet me të dhënat e Barometrit të Sigurisë së Ballkanit Perëndimor për Besimin, Korrupsionin dhe Integritetin në Institucionet Publike në Kosovë⁶⁸, ku 67% e qytetarëve do ta zgjidhnin Policinë e Kosovës si institucionin e parë ku do ta raportonin korrupsionin. Ky rezultat tregon se qytetarët e shohin policinë si portën e parë ku mund të denoncojnë, por gjithashtu ngre pyetje mbi efektivitetin e saj në trajtimin e denoncimeve, duke qenë se policia vetë perceptohet si një ndër institucionet më të prekura nga korrupsioni.

⁶⁸ Kosovar Centre for Security Studies (KCSS). 2022. WBSB Public Perception on Trust, Corruption, and Integrity of Public Institutions in Kosovo. Prishtinë: KCSS.
https://qkss.org/images/uploads/files/WBSB_2022_Kosovo_Report_1_Dec_2022_ENG.pdf

102. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (26.3%) dhe institucioni ku ka ndodhur korrupsioni (26.3%) ndajnë një peshë të barabartë si destinacione të raportimit. Kjo sugjeron se qytetarët, në mungesë të besimit të plotë të një mekanizëm i vetëm, shpesh zgjedhin të raportojnë drejtpërdrejt aty ku është kryer shkelja ose të drejtohen tek agjencia e dedikuar, ndonëse në numra shumë të kufizuar. Kurse një pjesë e vogël, 11 për qind, kanë zgjedhur të drejtohen te media, duke e përdorur atë si një kanal alternativ për ekspozimin e rasteve.

103. Prej atyre pak qytetarëve që ndërmorën hapin për të denoncuar korrupsionin, rreth 30 për qind e raportimeve kanë rezultuar në nisjen e një procedure formale kundër zyrtarit përkatës (Tabela 4). Megjithatë, një përqindje po aq e lartë është përgjigjur se nuk e di çfarë ka ndodhur pas raportimit, gjë që dëshmon mungesë transparence dhe komunikimi nga institucionet për hapat e ndërmarrë. Një e katërta e atyre që kanë raportuar kanë thënë se nuk pati asnjë veprim më pas, ndërsa 18 për qind kanë pohuar se problemi u zgjidh në mënyrë joformale dhe atyre u janë kthyer paratë apo dhuratat.

Tabela 4 - Rezultati i raportimit të rasteve të korrupsionit. Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2025

Rezultati i raportimit të rasteve të korrupsionit	Përqindja
Një procedurë formale filloi kundër zyrtarit përkatës	29%
Nuk e di	29%
Nuk pati asnjë veprim pas raportimit tim	24%
Problemi u zgjidh në mënyrë joformale dhe u kthyen pagesat/dhuratat	18%

104. Kur u pyeten se çfarë do t'u ndihmonte të ndërmerrnin veprime kundër korrupsionit, qytetarët e bënë të qartë se nuk mjafton vetëm vullneti personal – ajo që mungon është një rrjet i sigurt dhe i besueshëm kanalesh raportimi. Më së shumti, qytetarët kërkojnë kanale anonime raportimi (25.5%). Pra, anonimiteti shihet si garanci që një qytetar të mund të flasë pa u ndier i rrezikuar nga hakmarrja ose stigmatizimi. Kjo gjetje është në përputhje me raportet ekzistuese mbi mbrojtjen e sinjalizuesve në Kosovë: ndonëse institucionet qeveritare kanë caktuar zyrtarë për sinjalizim, shumica ende nuk i kanë publikuar emrat e tyre në faqet zyrtare⁶⁹. Për më tepër, janë evidentuar raste të izoluara intimidimi ose sulmesh ndaj sinjalizuesve, duke krijuar perceptimin se mbrojtja ligjore nuk është gjithmonë funksionale në praktikë⁷⁰.

105. Në të njëjtën linjë, rreth 25 për qind theksojnë nevojën për mbrojtje më të mirë ligjore për sinjalizuesit. Kurse institucionet e besueshme (19.3%) renditen gjithashtu lart në listë, duke treguar se raportimi nuk varet vetëm nga ekzistenca e kanaleve, por edhe nga perceptimi i integritetit të institucioneve që i menaxhojnë ato. Nëse qytetarët nuk u besojnë këtyre institucioneve, edhe kanalet më të sofistikuar mbeten të pashfrytëzuara.

⁶⁹ Transparency International. 2024. Between anti-corruption reform and decline: Examining key actors, strengths and weaknesses in the Western Balkans and Türkiye's national integrity systems. Berlin: Transparency International. https://images.transparencycdn.org/images/2024_NISReport_BetweenAnti-CorruptionReformAndDecline_English.pdf

⁷⁰ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). 2023. Moszbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

106. Një nga gjetjet më domethënëse të anketës lidhet me perceptimin e qytetarëve për lidhjen midis korrupsionit dhe të drejtave të tyre themelore. Shumica dërmuese besojnë se korrupsioni përbën shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave të njeriut (Figura 4). Ky rezultat nuk është vetëm një shifër e lartë statistikore, por një tregues i qartë i ndërgjegjësimit të qytetarëve se korrupsioni nuk është thjesht një devijim administrativ, por një fenomen që cenon barazinë, dinjitetin dhe qasjen e drejtë në shërbime publike. Për më tepër, analizat e Komisionit Evropian për Kosovën 2024⁷¹ tregojnë që mungesa e zbatimit të ligjit dhe interferenca politike minojnë të drejtën e qytetarëve për barazi përpara ligjit dhe qasje të drejta në institucionet publike.




Figura 4 - Qëndrimet e qytetarëve mbi ndikimin e korrupsionit në të drejtat e tyre. Burimi: Anketa e Institutit Riinvest 2025

107. Ky rezultat është veçanërisht i rëndësishëm, sepse tregon se korrupsioni perceptohet nga qytetarët jo vetëm si pengesë për zhvillimin ekonomik apo funksionimin e administratës, por mbi të gjitha si një çështje që prek drejtpërdrejt të drejtat e tyre themelore. Një interpretim i tillë e vendos korrupsionin në zemër të debatit mbi barazinë dhe qasjen e drejtë në shërbime, duke theksuar se çdo akt abuzimi me pushtetin përkthehet në një dëm konkret për qytetarin. Kjo gjetje krijon gjithashtu hapësirë për fushata ndërgjegjësimi dhe reforma institucionale, duke vënë në pah mesazhin se korrupsioni nuk është thjesht një devijim administrativ, por një fenomen që minon besimin, dëmton barazinë para ligjit dhe pengon ushtrimin e lirë të të drejtave. Ky interpretim gjen mbështetje edhe në Raportin mbi të Drejtat e Njeriut i Departamentit të Shtetit të ShBA-së⁷², i cili thekson se, ndonëse qeveria ndërmoi hapa për të hetuar dhe ndëshkuar shkeljet, ato shpesh ishin të paqëndrueshme dhe selektive.

⁷¹ European Commission. 2024. Kosovo 2024 Report. Commission Staff Working Document accompanying the Communication on EU enlargement policy. Brussels: European Commission.

https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en

⁷² US Department of State. 2024. Kosovo 2024 Human Rights Report. Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor. https://www.state.gov/wp-content/uploads/2025/07/624521_KOSOVO-2024-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf

108. Kur thellohem i te të drejtat konkrete të mohuara për shkak të korrupsionit, më e prekura del të jetë e drejta për kujdes shëndetësor, e përmendur nga gati gjysma e të anketuarve (44.6%) (Tabela 5). Ky rezultat pasqyron realitetin e përditshëm të qytetarëve, që u dëshmuar edhe nga gjetjet e pyetjeve paraprake, ku pagesat joformale për shërbime mjekësore, vonesat në trajtim për ata që nuk japin ryshfet dhe qasja e pabarabartë në kujdes shëndetësor janë shndërruar në probleme sistemike.

Tabela 5 - Shkalla e perceptimit të shkeljes së të drejtave për shkak të korrupsionit. Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2025

E drejta e shkelur nga korrupsioni	Përqindja
E drejta për kujdes shëndetësor (Marrja e ryshfetit për kujdes mjekësor, trajtim i vonuar për ata që nuk paguajnë, qasje e pabarabartë).	44.6%
E drejta për arsim (Marrja e ryshfetit ose favorizim në pranimet në shkollë, notat, bursat).	11.3%
E drejta për punë dhe mundësi të barabarta (Korrupsioni në punësimin publik ose proceset e punësimit, nepotizmi ose favorizimi seksual).	9%
E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Marrja e ryshfetit në polici, prokurori ose gjykata; trajtim i pabarabartë sipas ligjit).	7.1%
E drejta për t'u dëgjuar dhe për mekanizmat e ankesës (Frikësim ose shkarkim gjatë raportimit të abuzimit ose korrupsionit).	5.7%
E drejta e pronës (Korrupsioni në regjistrimin e tokës, kthimin e pronës, dëbimet e paligjshme).	4.1%
E drejta për shërbime publike (Qytetarët nuk kanë mundësi të përfitojnë nga shërbimet pa ryshfete, lidhje ose besnikëri politike).	3.9%
E drejta për identitet dhe dokumentacion ligjor (Marrja e ryshfetit për lëshimin e dokumenteve të identitetit, certifikatave të lindjes, pasaportave).	2.8%
E drejta për të marrë pjesë në punët publike (Përfshirja e grupeve të caktuara për shkak të rrjeteve politike ose klienteliste).	2.5%
Liria e shprehjes dhe informacionit (Mungesa e transparencës, heshtja e zërave antikorrupsion, kapja e medias).	2.1%
E drejta për mbrojtje sociale (Pagesa të paligjshme ose nepotizëm për qasjen në ndihmë sociale, pensione, mbështetje për papunësi ose aftësi të kufizuara).	2%
Mbrojtja nga diskriminimi (Grupet e marginalizuara përballen me më shumë korrupsion ose u mohohet qasja e barabartë në shërbime).	2%
E drejta për pjesëmarrje politike (Korrupsioni në zgjedhje, emërimet politike ose financim të partive).	0.9%
E drejta për ujë dhe kanalizime (Dhënia e ryshfetit ose qasje e pabarabartë në shërbime dhe infrastrukturë).	0.8%
E drejta për mjedis jetësor (Marrja e ryshfetit për lëshimin e lejeve të ndryshme: lejeve ujore, mjedisore etj., duke cenuar të drejtat e njeriut, p.sh. kur jepet leja për hidrocentrale pa aprovimin e banorëve).	0.7%
E drejta për strehim (Ndarje korruptive e banesave sociale, kërcënime për dëbim nëse nuk paguhen ryshfetet).	0.5%

109. Arsimi shfaqet si fusha e dytë më e goditur: 11 për qind e qytetarëve raportojnë se korrupsioni ua ka mohuar qasjen e drejtë dhe të barabartë në shkollim, përmes ryshfeteve, favorizimit në pranime, notave apo bursave. Një tjetër segment i rëndësishëm është e drejta për punë dhe mundësi të barabarta, e përmendur nga 9 për qind e të anketuarve. Rastet e korrupsionit në punësim publik, nepotizmi apo favorizimi shfaqen si pengesa serioze për meritokracinë dhe për të ardhmen profesionale të individëve.
110. Në të njëjtën kohë, rreth 7 për qind e qytetarëve theksojnë shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke pasqyruar bindjen e gjerë se sistemi i drejtësisë mbetet i ndjeshëm dhe i ekspozuar ndaj ndikimit të korrupsionit. Të drejtat e tjera të përmendura përfshijnë pronën (4.1%), shërbimet publike (3.9%), identitetin dhe dokumentacionin ligjor (2.8%) dhe mbrojtjen nga diskriminimi (2.0%).
111. Në raste më sporadike, qytetarët përmendin ndikimin e korrupsionit edhe mbi lirinë e shprehjes dhe informacionit (2.1%), pjesëmarrjen politike (0.9%), strehimin (0.4%) dhe të drejtën për një mjedis jetësor të shëndetshëm (0.7%). Edhe pse më të rralla, këto raste tregojnë se korrupsioni ka një ndikim që prek nga aspektet bazike të mirëqenies deri te pjesëmarrja në jetën publike.
112. Kur qytetarët reflektojnë mbi arsyet pse korrupsioni vazhdon ta dëmtojë jetën e tyre dhe t'i shkelë të drejtat themelore, gishtin e drejtojnë jo aq te mungesa e ligjeve, por te boshllëqet që e bëjnë sistemin të brishtë. Për ta, problemi nuk është se rregullat mungojnë, por se ato nuk zbatohen, se institucionet shpesh ndikohen nga politika dhe se mekanizmat e ankesës nuk funksionojnë si duhet. Pikërisht këto dobësi strukturore shihen si pengesa kryesore që i lënë qytetarët të pambrojtur përballë korrupsionit.

Tabela 6 - Boshllëqet kryesore institucionale që pengojnë mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nga korrupsioni. Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2025

Boshllëqet institucionale	Përqindja
Mungesa e zbatimit të ligjit	26%
Ndëshkueshmëria e ulët e rasteve të korrupsionit	12%
Mungesa e transparencës	10%
Mungesa e pavarësisë së gjyqësorit	8%
Mbrojtje e pamjaftueshme për sinjalizuesit	8%
Ndikimi politik në emërimet dhe promovime	8%
Mungesa e edukimit dhe informimit publik për të drejtat	8%
Kapacitet i kufizuar i institucioneve për hetim dhe ndjekje penale	7%
Mungesa e mekanizmave efektivë të ankesave	7%
Mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve	6%

Mungesa e zbatimit të ligjit u identifikua si problemi kryesor, i përmendur nga mbi gjysma e të anketuarve (26.4% e përgjigjeve / 65.3% e rasteve). Kjo gjetje është një tregues i fortë se qytetarët nuk shohin mungesë në legjislacion, por te zbatimin e tij. Pra, ligjet ekzistojnë, por nuk zbatohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë (Tabela 6).

113. Pas kësaj, dy boshllëqe të tjera të mëdha lidhen drejtpërdrejt me sistemin e drejtësisë: ndëshkueshmëria e ulët e rasteve të korrupsionit (12.4%) dhe mungesa e pavarësisë së gjyqësorit (8.2%). Këto tregojnë se korrupsioni perceptohet si një fenomen i toleruar për shkak të mungesës së sanksioneve dhe ndikimit të faktorëve politikë mbi drejtësinë. Në të

njëjtën linjë, ndikimi politik në emërimet dhe promovime (7.7%) shihet si një tjetër burim mosbesimi.

114. Dimension tjetër i theksuar është mungesa e transparencës (10.4%), e lidhur ngushtë me mungesën e mekanizmave efektivë të ankesave (6.8%) dhe me mbrojtjen e pamjaftueshme për sinjalizuesit (7.6%). Qytetarët duket se e shohin mungesën e informacionit të qartë, procedurave të thjeshta dhe garancive për mbrojtje si pengesa kyçe për ta luftuar korrupsionin. Po ashtu, kapacitetet e kufizuara të institucioneve për hetim dhe ndjekje penale (7.5%) dhe mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve (5.0%) dëshmojnë perceptimin se mekanizmat aktualë janë fragmentarë dhe joefikasë, duke krijuar hapësira për pandëshkueshmëri.
115. Një pjesë e qytetarëve theksojnë edhe mungesën e edukimit dhe informimit publik për të drejtat (7.9%), duke sugjeruar se korrupsioni shpesh lulëzon aty ku qytetarët nuk janë të vetëdijshëm për instrumentet ligjore dhe institucionale që mund t'i përdorin për t'u mbrojtur. Gjithashtu, qytetarët shfaqin qëndrime të ndryshme mbi nivelin e bashkëpunimit me institucionet për të zbuluar dhe parandaluar korrupsionin. Një pjesë e konsiderueshme (29.5%) mendojnë se ky bashkëpunim mungon plotësisht, ndërsa pothuajse një e treta besojnë se ai është i plotë. Për më tepër, 27 për qind e shohin atë si të pjesshëm ose deri diku të pranishëm.

Rezultatet nga intervistat me institucione

116. Për trajtim gjithëpërfshirës të temës së korrupsionit dhe ndikimit të tij në të drejtat e njeriut, përpos perceptimit dhe përvojave të qytetarëve, është me rëndësi të analizohet edhe perspektiva institucionale. Për këtë arsye, gjatë këtij hulumtimi janë organizuar 19 intervista me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave, duke përfshirë organet e pavarura mbikëqyrëse, agjencitë e sundimit të ligjit, institucionet gjyqësore, organizatat e të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile. Të gjeturat e mëposhtme rezultojnë nga intervistat e realizuara.
117. Intervistat me përfaqësues të institucioneve publike, mediale dhe organizatave të shoqërisë civile zbulojnë një tablo të qartë: korrupsioni në Kosovë është dukuri e pranishme dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në të drejtat e njeriut. Përpos rryshfetit, korrupsioni manifestohet në formë të favorizimit, nepotizmit, klientelizimit dhe abuzimit të detyrave zyrtare, duke prekur kështu të drejtat themelore për qasje në shërbime publike, shëndetësi, arsim cilësor, punësim dhe mjedis të pastër.
118. **Spektori i shëndetësisë** rezulton të jetë ndër më të prekurit nga korrupsioni. Pagat e ulëta të zyrtarëve publikë dhe niveli i ulët i digjitalizimit të proceseve administrative krijojnë hapësira për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Intervistat theksojnë raste kur pacientëve u kërkohet mito për trajtim më të shpejtë, ndërsa ata që nuk paguajnë detyrohen të presin në lista të gjata. Si rezultat, qasja e barabartë në shërbime shëndetësore cenohet rëndë. Andaj, për shumë qytetarë, pagesa nën dorë është bërë praktikë e normalizuar, duke mbështetur gjetjet nga anketa me qytetarë. Për personat e tjerë që bëjnë ankesë, rasti shqyrtohet nga organet kompetente dhe, nëse ekzistojnë prova të mjaftueshme, ndërmerren masat e nevojshme, siç janë: gjoha me pagesë, vërejtje me shkrim, apo ndërrim i vendit të punës për zyrtarin që ka keqpërdoruar detyrën. Fatkeqësisht, në shumicën e rasteve të raportuara, provat nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar korrupsionin. Mirëpo, edhe favorizimet ndërmjet inspektorëve dhe stafit shëndetësor e

pengojnë zgjidhjen e rasteve në kohë dhe mënyrë të duhur. Duke pasur parasysh këto probleme, qytetarët kryesisht raportojnë raste që mund të vërtetohen lehtë dhe të sanksionohen menjëherë, siç janë shkeljet e orarit të punës dhe sjellja joprofesionale e stafit.

119. **E drejta për punësim** është po ashtu ndër të drejtat qenësore më të prekura nga korrupsioni në Kosovë. Nepotizmi dhe favorizimi kufizojnë konkurrencën e ndershme dhe shmangin meritokracinë në punësim dhe avancim në karrierë. Për më tepër, prania e lartë e korrupsionit në tregun e punës ndikon që shumë punëdhënës të mos i respektojnë të drejtat e punëtorëve të garantuara me ligj, duke përfshirë: moskompensimin e orëve shtesë, vikendeve dhe festave; mosdhënia e pushimeve vjetore dhe mjekësore; puna pa kontratë dhe mohimi i pagesës së lejes së lehonisë. Përderisa korrupsioni nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e Ligjit të Punës, ka ndikim të tërthortë përmes heshtjes së rasteve të raportuara për shkak të aferave korruptive nga inspektorët dhe punëdhënësit përkatës. Veprimet e tilla përpos që dekurajojnë qytetarët, rrisin edhe mosbesimin e tyre në funksionimin e organeve kompetente. Disa prej të intervistuarve shprehin shqetësimin e tyre se këto sjellje janë ndër faktorët kryesorë që kanë kontribuar në migrimin masiv të të rinjve, të cilët nuk shohin perspektivë profesionale në vend.
120. Prania e korrupsionit në punësim prek edhe të drejtën për arsim cilësor. Nëse zyrtarët arsimorë janë punësuar pa meritë, kjo përcjell shumë gjenerata studentësh që pësojnë nga mësimdhënës joadekuatë për pozitat e tyre. **Mosofrimi i arsimit cilësor** është dekurajues dhe demotivues për nxënësit dhe është kundër çdo garantimi ligjor dhe kushtetues brenda vendit. Fatkeqësisht, kjo mbetet dukuri mjaft e pranishme në shoqërinë tonë dhe shpërfaq ndikimin e tërthortë të korrupsionit në të drejtat e nxënësve për arsim cilësor. Ndikimi i tërthortë shfaqet edhe në rastet kur paraja publike keqpërdorohet në formë të tillë që mohon ndërtimin e objekteve të reja shkollore, duke kufizuar qasjen në infrastrukturë adekuate. Përpos kësaj, korrupsioni ka edhe ndikim të drejtpërdrejtë në arsim, sidomos në ato raste kur nxënësve u mohohet qasja e barabartë në bursa studimi, pjesëmarrje në konferenca dhe grupe punuese, trajtim i pabarabartë në procesin e aplikimit në një institucion arsimor, si dhe marrja e notave pa meritë. Edhe pse numri i rasteve të raportuara është zvogëluar dukshëm ndër vite, nuk përjashtojmë prezencën e kësaj dukurie në Kosovë. Për më tepër, mungesa e inspektorëve arsimorë e vështirëson identifikimin dhe zgjidhjen e rasteve.
121. Qytetarëve, përpos së drejtës për punësim, shëndetësi e arsim, u takon edhe e drejta për **mjedis të pastër dhe jetë të shëndetshme**. Madje, kjo e drejtë është ndër më kryesoret, me ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin fizik dhe mendor të qytetarëve. Korrupsioni ka ndikim të madh në cilësinë e ambientit ku jetojmë dhe shfaqet përmes mosfunksionimit të institucioneve, keqpërdorimit të fondeve publike, dhënies së lejeve mjedisore dhe ndërtimore pa plan, vonesave në përpunimin e rasteve dhe mungesës së kompetencave institucionale. Këto dobësi ndikojnë që të degradohet mjedisi, uji, të mos bëhet mirëmbajtja e hapësirave publike dhe mbeturinat ta pengojnë funksionimin e aktiviteteve ditore. Nga intervistat e realizuara kuptohet se ekzistojnë perceptime të shumta nga qytetarët se keqpërdorimi i detyrës zyrtare shfaqet më së shpeshti në dhënien e lejeve mjedisore dhe atyre ndërtimore. Institucionet relevante shprehin se lejet mjedisore janë brenda parametrave të paraparë me ligj dhe se nuk rrezikojnë degradimin e mjedisit. Në ato raste kur ka pasur shqetësim për keqpërdorim, janë marrë masat e nevojshme që kanë

ndalur aktivitetin e kompanive derisa është zgjidhur problemi. Për sa i përket numrit të raportimeve për korrupsion, numri ka rënë ndër vite, mirëpo edhe në këtë aspekt mungesa e një numri efektiv të inspektorëve vështirëson trajtimin e rasteve në kohë të kënaqshme. Pavarësisht se ekzistojnë mekanizma, mungon koordinimi i harmonizuar ndërinstitutional mes trupave përgjegjës për kujdesin e mjedisit. Ky çalim ka ndikuar që rastet e raportuara ose të shuhen, ose të zgjatet procedura aq sa të kalojnë në heshtje administrative, ose zyrtarët e korrumpuar të mos gjobiten për veprat e tyre. Mungesa e një divizioni për matjen e dëmit financiar ndikon që qytetarëve të mos u paguhet vlera reale e dëmit, sepse merret vlera minimale e dëmit të shkaktuar. Po ashtu, mungesa e mekanizmave dënues ndaj veprimeve korruptive të stafit ngre pyetje rreth integritetit të zyrtarëve publikë në trajtimin e rasteve.

122. Për sa i përket **qasjes në administratë publike**, digjitalizimi i proceseve administrative ul mundësitë për korrupsion, meqë evitohet takimi mes palëve, dhe të gjithë qytetarëve u ofrohet qasje e barabartë. Digjitalizimi shihet si metoda më efektive në parandalimin e korrupsionit dhe është ndër rekomandimet kryesore nga shumë institucione të intervistuar.

123. Pavarësisht rasteve të sipërpërmendura rreth pranisë së korrupsionit në sektorë të ndryshëm, të gjitha institucionet kanë zyrtarin për sinjalizim, platforma, linja të hapura për thirrje dhe raportime përmes e-mailit dhe raportime fizike, gjithnjë duke ruajtur konfidencialitetin e palëve. Kjo mundëson që qytetarët në çdo kohë t'i raportojnë shqetësimet e tyre për korrupsion apo ndonjë keqpërdorim tjetër të detyrave zyrtare. Rastet e pranuar nga këto platforma, pas shqyrtimit dhe vlerësimit, dërgohen në organet kompetente, të cilat merren me zhvillimin e rastit më tutje. Gjatë intervistave është evidentuar bashkëpunimi i vazhdueshëm i institucioneve me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe sistemin gjyqësor, duke theksuar se ekziston vullneti për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Sidoqoftë, sfidë mbetet periudha e gjatë për zgjidhjen e një rasti, duke bërë që qytetarët shpesh t'u drejtohen organizatave mediale për ta shpejtuar procesin. Mirëpo, edhe organizatat mediale përballen me sfidat e tyre, sepse disa nuk arrijnë të sigurojnë qasje në dokumente publike, duke vështirësuar procesin e trajtimit të rastit më tutje, ndërsa në rastet e tjera, mediat mund të jenë të politizuara nga brenda, duke ngritur pikëpyetje rreth integritetit medial në vend.

Tabela 7 - Gjetjet kryesore nga intervistat me institucione. Burimi: Intervistat e realizuara nga Instituti Riinvest, 2025

Të drejtat e njeriut	Ndikimi i korrupsionit	Masat aktive	Rekomandime
E drejta për shëndetësi	- Qytetarë që u është mohuar e drejta për trajtim në rastet kur nuk kanë paguar ryshfet; - Zgjatje e procedurave shëndetësore pa nevojë; - Mosrespektimi i orëve të punës;	- Linja e hapur për raportim, e cila ruan konfidencialitetin e raportuesit plotësisht; - Ndaj palës dëmtuese merren masa si: vërejtje me shkrim, gjoba apo ndërrim i vendit të punës; - Plani i integritetit dhe sinjalizuesi që merret	- Rritja e pagave të inspektorëve ul iniciativat për korrupsion; - Inspektorët shëndetësorë duhet zgjedhur nga fushat e parapara me ligj: farmacistë, doktorë, apo stomatologë; - Digjitalizimi i procedurave administrative;

	- Rekomandim nga ana e mjekut për kontroll në ordinancë private, edhe për shërbime që ofrohen në shëndetësinë publike; - Mosplanifikim i mirëfilltë i buxhetit të ndarë për barna.	me rastet e raportuara.	- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duhet t'i trajtojë rastet e raportuara meqë është më kompetente; - Stimuj financiarë për sinjalizuesit.
E drejta për qasje në administratë publike	- Vonesa në trajtimin e lëndës; - Pagesë për përshpejtimin e procedurës; - Trajtim i pabarabartë i rasteve.	- Platforma online dhe e-maili për paraqitjen e ankesave; - Aplikacioni për paraqitjen e ankesave; - Trajtim i menjëhershëm i rastit dhe transparencë gjatë gjithë procedurës; - Zyrtar për konflikt interesi, parandalim korrupsioni e dhurata.	- Zgjatja e afatit kohor që lejon trajtimin dhe mbylljen e rastit; - Trajnimi i qytetarëve rreth të drejtave të tyre dhe ndikimin që korrupsioni ka në to; - Ndryshim-plotësim i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve; - Trajnime për stafin rreth Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve; - Digjitalizimi i shërbimeve administrative.
E drejta për arsim	- Nxënës që u është mohuar e drejta për bursë për shkak të ndërhyrjeve klienteliste; - Prindër që paguajnë për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë, apo për kalimin e provimeve; - Mungesë e objekteve arsimore për shkak të keqpërdorimit të fondeve publike; - Mosofrim i arsimit cilësor si pasojë e punësimeve pa meritokraci.	- Sinjalizuesi dhe plani i integritetit është i pranishëm në institucionet edukativo-arsimore; - Linja online, e-maili dhe mundësia për raportim fizik të rasteve.	- Rritje e numrit të inspektorëve arsimorë; - Duhet përforcuar monitorimi i zbatimit të ligjit.
E drejta për punësim	- Individë që u është mohuar punësimi apo avancimi në punë për shkak të nepotizmit; - Punësime jomeritore; - Shkelja e të drejtave të punëtorit, të garantuara me Ligjin	- Inicimi i procedurave disiplinore; - Linja pa pagesë për raportim, ankesat fizike dhe ato elektronike.	- Trajnime mbi integritetin e inspektorëve; - Krijimi i një mekanizmi mbikëqyrës më të mirë; - Digjitalizimi i procesit të inspektimit.

	e Punës, dhe mbyllja e rastit nga korruptimi i inspektorëve.		
E drejta për mjedis të pastër, qasje në ujë të pijshëm, e jetë të shëndetshme	- Degradimi i mjedisit, ujit dhe ajrit ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve; - Ofrimi i gypave të dobët për furnizim me ujë, që ndikon në cilësinë e ujit që u shkon qytetarëve; - Mungesa e një mjedisi të pastër si pasojë e keqpërdorimit të fondeve publike; - Ofrimi i lejeve ndërtimore dhe mjedisore që keqpërdorjnë mjedisin.	- Linja elektronike dhe e-maili ku qytetarët shprehin shqetësimet e tyre; - Sinjalizuesi që merret me rastet e raportuara; - Transparencë për qasje në dokumente publike; - Transparencë buxhetore.	- Rritje e numrit të inspektorëve mjedisorë; - Trajtim më i shpejtë i rasteve dhe qasje më e mirë ndaj qytetarëve raportues; - Harmonizimi i ligjeve ekzistuese me njëra-tjetrën; - Krijimi i një divizioni për vlerësimin e dëmit; - Dënime më të ashpra financiare.
E drejta për ushqim dhe zhvillim rural	- Shpërndarja e pabarabartë e burimeve; - Qasje e pabarabartë në subvencione; - Humbje e besimit në organet kompetente.	- Procesimi i vlerësimit të subvencioneve është transparent dhe i paanshëm; - Ndërmerren masa ndaj punëtorëve që shkelin parimet e barazisë; - Linja e hapur për thirrje.	- Krijimi i komisioneve ku qytetarët kanë të drejtë ankese.
E drejta për drejtësi	- Prek të drejtën për gjykim të drejtë; - Qasje e pabarabartë në trashëgimi dhe bartje të pronës; - Qasje e pabarabartë në licencim apo certifikim për noter, përmbaues, ekspert financiar.	- Sinjalizuesi që merret me rastet e raportuara; - Provimet për noter dhe përmbaues janë digjitalizuar; - Bashkëpunimi i ndërsjellët me institucionet e tjera; - Linja e hapur për thirrje.	- Digjitalizimi i proceseve administrative; - Ofrimi i stimuljeve financiar për sinjalizuesit; - Digjitalizimi i procesit të intervistave për noter, përmbaues; - Implementim dhe monitorim më i mirë i ligjeve ekzistuese.

Konstatimet

124. Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore përbën një nga vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Megjithatë, të gjeturat e këtij raporti tregojnë se korrupsioni vazhdon të paraqesë pengesë serioze për realizimin efektiv të këtyre të drejtave.
125. Analiza e bazës ligjore, standardeve ndërkombëtare, rezultateve të anketës dhe intervistave me institucionet dëshmon se korrupsioni prek drejtpërdrejt ose tërthorazi një gamë të gjerë të drejtash, përfshirë të drejtën për shëndetësi, arsim, punësim, mjedis të shëndetshëm, administrim të mirë dhe gjykim të drejtë.
126. Avokati i Popullit konstaton se qytetarët kanë nivel të lartë të vetëdijesimit për format tradicionale të korrupsionit, si: ryshfeti, nepotizmi, klientelizmi dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare, megjithëse një pjesë e praktikave korruptive vazhdojnë të tolerohen ose normalizohen në jetën e përditshme.
127. Të gjeturat tregojnë se ekziston dallim ndërmjet perceptimit të qytetarëve për korrupsionin dhe përvojave të tyre konkrete. Ndërsa sistemi gjyqësor, shëndetësia dhe arsimi perceptohen si sektorët më të prekur, përvojat direkte me ryshfetin raportohen më shpesh në procedurat administrative, në sektorin e drejtësisë dhe në kontaktet me organet e rendit.
128. Avokati i Popullit konstaton se korrupsioni në sektorin e shëndetësisë cenon të drejtën për shëndet dhe trajtim të barabartë, ndërsa korrupsioni në administratën publike dhe sistemin e drejtësisë cenon sigurinë juridike, barazinë para ligjit dhe besimin e qytetarëve në institucionet publike.
129. Përkundër ekzistimit të një kornize të avancuar ligjore dhe mekanizmave institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, zbatimi i tyre në praktikë vazhdon të përballlet me sfida të konsiderueshme, përfshirë procedurat e gjata, kapacitetet e kufizuara institucionale, koordinimin e pamjaftueshëm ndër-institucional dhe nivelin e ulët të besimit të qytetarëve.
130. Avokati i Popullit vëren se mosbesimi në efektivitetin e institucioneve dhe mungesa e njohurive për mekanizmat ekzistues të raportimit mbeten ndër arsyt kryesore që pengojnë raportimin e rasteve të korrupsionit nga qytetarët.
131. Edhe pse shumica e institucioneve kanë krijuar mekanizma formalë për sinjalizim dhe raportim të korrupsionit, frika nga hakmarrja dhe perceptimi për mungesë të rezultateve konkrete vazhdojnë të ndikojnë negativisht në përdorimin e tyre nga qytetarët.
132. Avokati i Popullit konstaton se mungesa e kontrollit të drejtpërdrejtë gjyqësor ndaj vendimeve të Prokurorit të Shtetit për hedhjen e kallëzimeve penale dhe pushimin e hetimeve në rastet e korrupsionit rrit përgjegjësinë e organeve të prokurorisë për të siguruar trajtim të kujdesshëm, objektiv dhe të arsyetuar të këtyre rasteve, veçanërisht kur ato lidhen me pretendime për cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
133. Të gjeturat nga intervistat evidentojnë se digjitalizimi i proceseve administrative paraqet një nga mekanizmat më efektivë për rritjen e transparencës, uljen e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet qytetarëve dhe zyrtarëve publikë dhe reduktimin e hapësirës për veprime korruptive.

134. Avokati i Popullit konstaton se mungesa e Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit kufizon koordinimin institucional dhe vështirëson zhvillimin e një qasjeje të unifikuar dhe afatgjatë për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë.
135. Në tërësi, raporti tregon se korrupsioni mbetet një sfidë strukturore për sundimin e ligjit, funksionimin e institucioneve publike dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut, duke kërkuar masa më të fuqishme, më të koordinuara dhe më të qëndrueshme nga të gjitha institucionet përgjegjëse.
136. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...].”*

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Qeverisë së Republikës së Kosovës:

1. Ta miratojë Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit dhe Planin e saj të Veprimit, duke u bazuar edhe në të gjeturat e këtij raporti.

Këshillit Gjyqësor të Kosovës:

1. Të draftohen dhe publikohen raporte periodike lidhur me zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore.

Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

1. Të rriten kapacitetet e APK-së për mbulim adekuat të të gjitha fushave që kanë të bëjnë me parandalimin e korrupsionit.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*) dhe me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit (*“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”*), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit